



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 1774, datë 02. 02. 2012

Për

“Miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm”.

Këshilli Drejtues **(KD)** i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare **(AKEP)**, i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtare |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtare |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Elda Topi, në mbledhjen e datës 02.02.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm”.

BAZA LIGJORE:

1. Germa p) të nenit 8, nenit 13 e vijues dhe pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,
2. Neni 127, 128 i Ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
3. Pika 17 e nenit 21 “Rregullores së Brendshme të AKEP (ish ERT) miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. Rregullore për Njotimin e Autorizimit të Përgjithshëm, miratuar me VKD nr. 495 datë 19. 09. 2008;
5. Urdhër i Kryetarit Nr. 571, datë 24.05.2010, i ndryshuar me Urdhër nr. 796 date 23.01.2012.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të grupit të punës si me poshtë:

- Relacioni shpjegues “Për Miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm”,
- Projekt aktet e paraqitura për miratim:
 1. Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm.

1.1 Aneks A, Njoftimi i Regjistrimit.

1.2 Aneks B, Çertifikata e Konfirmimit, sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

1.3 Aneks C, Kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm,

- Raporti perfundimtar mbi procedurën e zhvilluar të keshillimit publik dhe përfundimet e tij;
- Mendimet formale të paleve të interesuara të depozituara me shkrim në AKEP;
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- Relacioni shpjegues “Për Miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm”,
- Projekt aktet e paraqitura për miratim:
 - 1. Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm.
 - 1.1 Aneks A, Njoftimi i Regjistrimit.
 - 1.2 Aneks B, Çertifikata e Konfirmimit, sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.
 - 1.3 Aneks C, Kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm,
- Raporti perfundimtar mbi procedurën e zhvilluar të keshillimit publik dhe përfundimet e tij;
- Mendimet formale të paleve të interesuara të depozituara me shkrim në AKEP;

janë përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë, propozimin e mbështetur të grupit të punës bazuar në parimet e efikasitetit dhe transparencës në administratën publike, qëllimin funksional të procedurës së parashikuar dhe rregullave të saj si dhe standartin e thjeshtëzuar të aplikacioneve të ndryshme për ofrim të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe përdorimin e burimeve natyrore të kufizuara,

V E N D O S :

1. Të miratojë dokumentin: ***Rregullore për “Autorizimin e Përgjithshëm” dhe anekset bashkelidhur:***
 - Aneks A, Njoftimi i Regjistrimit;
 - Aneks B, Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit,
 - Aneks C, Kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm,

2. Të miratoje komentet dhe qëndrimin e AKEP pas Keshillimit Publik për Rregulloren ***“Per Autorizimin e Përgjithshëm”***.
3. Sipërmarrësit e regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë formularin e njoftimit të regjistrimit (Ankesin A të rregullores) brenda 3 muajve nga data e miratimit të këtij vendimi. Për aplikuesit e rinj kjo rregullore aplikohet që nga data e miratimit të këtij vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

Nr. 24 datë 02.02.2012

PËR

AUTORIZIMIN E PËRGJITHSHËM

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1774, Datë 02.02.2012

RREGULLORE

Nr.24, datë 02.02.2012

PËR AUTORIZIMIN E PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të shkronjave d), p) dhe nj) të nenit 8, nenit 13 e vijues dhe pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Të përgjithshme

1. Kjo Rregullore, përcakton procedurat dhe kushtet e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të Komunikimeve Elektronike në Republikën e Shqipërisë, nën Regjimin e “Autorizimit të Përgjithshëm”, në zbatim të nenit 13 e në vijim të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Termat e përdorur në këtë Rregullore do kenë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me direktivat e BE për komunikimet elektronike dhe aktet e ITU dhe CEPT në fuqi.
3. Në kuptim të kësaj Rregulloreje, termi “personi/at” do të përdoret për çdo person fizik dhe juridik që aplikon në AKEP për Autorizim të Përgjithshëm.

Neni 2 Fusha e Zbatimit

1. Detyrimi për zbatimin e kësaj rregulloreje ekziston në të gjithë rastet kur personat e interesuar para-shikojnë të ofrojnë rrjete dhe shërbime publike në fushën e komunikimeve elektronike. Përgjashtim bëjnë vetëm rastet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 13, të Ligjit Nr. 9918.

Nëse ushtrimi i aktivitetit në fushën e komunikimit elektronik kërkon gjithashtu edhe dhënien e së drejtës së përdorimit për numeracion dhe frekuenca , përpara fillimit të aktivitetit, përveç pajisjes me Çertifikatën e Konfirmit të Njoftimit, personi/at i/e interesuar duhet të pajiset me Autorizim Individual .

2. Në zbatim të rregullimeve të parashtuara në këtë Rregullore, kushtet e përdorimit të frekuencave që përdoren pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdorin këto frekuenca, bazuar në faktin se rreziku i interferencave është minimal, janë përcaktuar nga AKEP me Rregulloren në fuqi “Mbi kushtet e përdorimit të frekuencave dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren pa autorizim individual”-miratuar me VKD nr. 1126, datë 08.01.2010.

KREU II

PROCEDURA DHE KUSHTET E AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 3

Procedura e Njoftimit

1. Për të ofruar rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm (AP), përpara fillimit të ushtrimit të aktivitetit personi/at i interesuar duhet që të kryejnë procedurën e Njoftimit duke plotësuar plotësuar një “Njoftim Regjistrimi” sipas formatit në aneksin A.
2. Njoftimi i Regjistrimit paraqitet me shkrim në AKEP duke plotësuar formularin e njoftimit online tek Moduli i Aplikimit Online për Autorizim të Përgjithshëm në faqen e web të AKEP: www.akep.al, në përputhje me modelin e Njoftimit të Regjistrimit të përfshirë në Aneksin A. Në Njoftimin e Regjistrimit, i interesuari duhet të plotësojë një ose më shumë zëra të aktivitetit që do të ushtrojë, sikurse përshkruhen në Aneksin A të këtij dokumenti
3. Kur informacioni për regjistrimin e një njoftimi nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj AKEP brënda 5 (pesë) ditëve nga depozitimi ose aplikimit online, njofton të interesuarin për nevojën e plotësimit/saktësimit të informacionit. I interesuari duhet të paraqesë duke plotësuar online tek Moduli i Aplikimit Online për Autorizim të Përgjithshëm, Njoftimin e Regjistrimit të plotë brënda 30 ditëve nga data e njoftimit të AKEP.
4. I interesuari i cili ka depozituar në AKEP duke plotësuar online një Njoftim Regjistrimi të plotë, dhe është pajisur me një certifikatë konfirmimi nga AKEP, ka të drejtë të ushtrojë vetëm aktivitetin/t e përcaktuara në Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të lëshuar nga AKEP-i.
5. Sipërmarrësit që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, janë të detyruar të njoftojnë AKEP sipas të njëjtës procedurë, çdo ndryshim kur:
 - (a) kërkohet të ofrohen rrjete dhe / ose shërbime publike të komunikimeve elektronike të tjera, përveç atyre të deklaruara në Njoftimin e Regjistrimit fillestar;
 - (b) kërkohet të mbyllë një ose disa nga rrjetet dhe / ose shërbimet publike të komunikimit elektronik të vendosura më parë në Njoftimin e Regjistrimit dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje;
 - (c) bëhet ndonjë ndryshim në detaje të Njoftimit të Regjistrimit.Çdo ndryshim në të dhënat duhet të njoftohet brënda 30 ditëve nga ndodhja e tyre.

6. Formulari (Njoftimi i Regjistrimit) i plotësuar sipas pikës 2, nënshkruhet nga sipërmarrësi në momentin e tërheqjes së Certifikates së Konfirmimit të Njoftimit dhe i bashkëngjitet praktikës që arkivohet në AKEP së bashku me dokumentacionin shoqërues.
7. Nëse sipërmarrësi brënda 30 ditëve nga njoftimi i AKEP nuk tërheq Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, AKEP nuk e regjistron sipërmarrësin në regjistrin e sipërmarrësve.
8. Sipërmarrësit të cilët për të ofruar rrjete/shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të përdorin burime të kufizuara (frekuenca dhe numeracion), duhet të plotësojnë në të njëjtën kohë edhe formën përkatëse të aplikimit për Autorizim Individual për dhënie në përdorim të frekuencave dhe numrave.

Neni 4

Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit

1. Bazuar në aplikimin sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, AKEP do të leshojë një certifikatë konfirmimi për sipërmarrësin, brënda 7 ditëve nga data e pranimit të aplikimit të plotë online.
2. Kjo Çertifikatë vërteton se:
 - (a) sipërmarrësi ka plotësuar një Njoftim Regjistrimi në formatin e duhur;
 - (b) sipërmarrësi do ofrojë rrjete dhe / ose shërbime publike të komunikimit elektronik sipas zërave të plotësuar në Njoftimin e Regjistrimit;
 - (c) sipërmarrësi do të zbatojë Kushtet e Përgjithshme të ofrimit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, të përcaktuara në Aneksin C të kësaj rregulloreje.
3. Forma dhe përmbajtja e Çertifikatës së Konfirmimit të Njoftimit përcaktohet sipas Aneksit B të kësaj Rregulloreje. Çertifikata do të printohet në dy kopje, një për sipërmarrësin dhe një kopje për AKEP.

Neni 5

Kushtet e Përgjithshme

1. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime publike të komunikimeve elektronike dhe operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm janë të detyruar të zbatojnë termat dhe kushtet e parashtruara në Aneksin C të kësaj Rregulloreje.
2. Sipërmarrësit që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, janë të detyruar të bashkëpunojnë me AKEP, sa herë që i kërkohet sipas parashikimeve të kësaj Rregulloreje, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe në bazë të rregullimeve të tjera të ligjeve të aplikueshëm, në fuqi. Ndër të tjera, bashkëpunimi duhet të lejojë dhe asistojë AKEP, për kontrollin e zbatimit të kushteve dhe termave të kësaj Rregulloreje, duke depozituar në AKEP të dhënat statistikore të përditësuara dhe hollësi të tjera lidhur me aktivitetet të cilat janë objekt i regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

3. Termat dhe kushtet që lidhen me ofrimin e rrjeteve dhe/ ose shërbimeve publike në regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm përcaktohen nga kuadri ligjor, i përcaktuar nga Ligji Nr.9918, nga aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP në zbatim të ligjit dhe ato të parashikuara në Aneksin C të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Regjistri i Sipërmarrësve

1. AKEP administron Regjistrin e sipërmarrësve së bashku me historikun e veprimeve, me anën e një baze të dhënash (database) të aksesueshme për të mundësuar aksesin në distancë. Regjistri i sipërmarrësve që publikohet do të përmbajë këto të dhëna:
 - a. emrin dhe adresën e sipërmarrësit;
 - b. numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT);
 - c. përfaqësuesi ligjor i regjistruar në QKR;
 - d. te dhenat (telefon, fax, email) të kontaktit me AKEP;
 - e. një përshkrim të shkurtër të aktivitetit qëdo të kryejë nëfushën e komunikimeve elektronike;
 - f. llojet e rrjeteve dhe shërbimeve publike që kërkohen të ofrohen;
 - g. numrin dhe datën e leshimit të Çertifikatës nga AKEP,
 - h. data e parashikimit të fillimit të aktivitetit;

Neni 7

Detyrimi për Dhënie Informacioni

1. Sipërmarrësit që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshme janë të detyruar të japin të dhëna/informacionin e duhur në AKEP në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”-miratuar me VKD nr. 1214, datë 07.04.2010.
2. Në varësi të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni, sipërmarrësit duhet të japin informacionin duke zbatuar afatet dhe detajimet e bëra në kërkesën e AKEP, që duhet të jenë objektive, të saktësuara dhe në zbatim të detyrimeve specifike.

Neni 8

Detyrimet e sipërmarrësve

1. Sipërmarrësit që ofrojnë Rrjete ose Shërbime Publike të Komunikimeve Elektronike nuk duhet të tejkalojnë deklaratimet e bëra në Njoftimin e Regjistrimit, ose kushtet e përgjithshme sikurse parashikohen në këtë Rregullore dhe në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet

Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ose në akte të tjera që mbulojnë kryesisht çështjet rregullatore.

2. Nëse sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime publike të komunikimit elektronik nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm nuk veprojnë në përputhje me kushtet e parashikuara në Autorizimin e Përgjithshëm, AKEP zbaton dispozitat e Kreut XVI, nenit 132 e vijues të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Neni 9

Mbyllja e Aktivitetit

1. Kur Sipërmarrësi mbyll aktivitetin e njoftuar dhe të regjistruar nga AKEP është i detyruar të njoftojë AKEP-in brenda 30 ditë nga data e mbylljes sipas formularit në Aneksin A. AKEP pasi verifikon plotësimin e detyrimeve ligjore të sipërmarrësit ben çregjistrimin e tij nga regjistri.
2. Nëse sipërmarrësit kanë njoftuar AKEP-in për mbylljen e aktivitetit dhe kanë në përdorim burime natyrore të fundme (frekuenca dhe numeracion), atëherë AKEP përveç veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, revokon vendimin/et respektive me të cilin/ët i është/janë dhënë të drejtat mbi burimet natyrore të fundme.
3. Nëse një sipërmarrës i regjistruar do të bëjë mbylljen e aktivitetit të tij për shkak të bashkimit me një subjekt tjetër, atëherë ai është i detyruar të njoftojë AKEP-in për ngjarjen e pritshme brenda 30 ditëve para ndodhjes. Sipërmarrësi i ri ka detyrimin të zbatojë procedurën për ndryshimet në Njoftimin e Regjistrimit, sipas kësaj rregulloreje.
4. Nëse të gjitha aktivitetet e komunikimit elektronik do të mbyllen, pagesat vjetore do të llogariten bazuar në rregullimet ligjore, nënligjore dhe akteve rregullatore në fuqi, deri në ditën e njoftimit, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 10

Pagesat

1. Sipërmarrësit që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, brenda afateve ligjore duhet të kryejnë pagesat, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

Publikimi

1. Kjo Rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj, publikohet në faqen e internetit të AKEP me miratimin e saj.
2. AKEP publikon dhe përditeson në faqen e internetit Regjistrin e sipërmarrësve

Neni 12

Shfuqizimi

Rregullorja Nr.3 datë 19.09.2008 “Për Njoftimin e Autorizimit të Përgjithshëm” miratuar me Vendimin Nr. 495, datë 19.09.2008 të Këshillit Drejtues të AKEP, shfuqizohet.

Neni 13

Dispozitë kalimtare

Të gjitha konfirmimet e njoftimit të lëshuara sipas rregullores Nr. 3 datë 19.09.2008 mbeten në fuqi dhe veprojnë deri në çastin e ndryshimit të tyre në perputhje me kerkesat e kesaj rregullore por jo më vonë se 3 muaj nga data e miratimit të saj.

Neni 14

Hyrja ne Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen web të AKEP.



ANEKS A

NJOFTIM REGJISTRIMI PËR OFRIMIN E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Hyrja në AKEP:	Drejtoria:	☐ Fillimi shërbimit	☐ Ndryshim të të dhënave
N.° Aplikimit:	Spektori:	☐ Shtim shërbimi	☐ Mbyllje të aktivitetit
Destinacioni:	Data / /	☐ Heqje shërbimi	☐ Fillimi ofrimit rrjetit

I. Të dhëna të nevojshme për identifikimin dhe komunikimin me personin.

Emri i Personit (juridik/fizik):		
Adresa Vendbanimi/Zyra qendrore e Personit (juridik/fizik):		
Qyteti / Shteti		
Telefon	Fax	E-mail/ Website
Personi (juridik/fizik) është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) në:		
Qarku/Rrethi/Qyteti:		Si: (SH.P.K./SH.A. etj.)
NIPT-i		

Emri i Përfaqësuesit ligjor të Personit (juridik/fizik)::		Numri personal i letërnjoftimit/kartës së identitetit-ID
Adresa		Kutia Postare
Qyteti		Qarku/Rrethi
Telefon	Fax	E-mail



Personi i Kontaktit (Drejtuesi Teknik)

Telefon

Fax

E-mail

II. DOSJA E PËRSHKRIMIT PËR RRJETET DHE SHËRBIMET

Përshkrimi i llojeve të rrjetit ose shërbimeve që Personi (juridik/fizik) do të ofrojë, si dhe koha e fillimit të aktivitetit:

- ☐ 1. Rrjete publike të komunikimeve elektronike: Datë: |.|.|.|.|
- ☐ 2. Shërbime publike të komunikimeve elektronike:
- ☐ a) Shërbime telefonike: Datë: |.|.|.|.|
- ☐ b) Shërbimi i aksesit në internet: Datë: |.|.|.|.|
- ☐ c) Shërbime të tjera: Datë: |.|.|.|.|

Personi (juridik/fizik) kërkon që t'i lëshohet çertifikata e konfirmimit të njoftimit e ofruesit të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike:

☐ Po

Personi (juridik/fizik) bashkëngjijt dokumentat e mëposhtem, të cilat janë pjesë e njoftimit:

- a) kopje të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe të çertifikatës së regjistrimit në organet tatimore, duke përfshirë edhe NIPT-in;
- b) kopje të aktit të themelimit, statutit, bashkë me ndryshimet dhe plotësimet e pësuara, dhe kopje të dokumentave që provojnë cilësinë e përfaqësuesit ligjor të personit të përmendur në njoftim;
- c) kopje të letërnjoftimit (kartës së identitetit) ID të personit (juridik/fizik), nëse ai është person fizik;
- d) përshkrimi teknik për rrjetet dhe/ose shërbimet që kërkon të ofrojë;
- e) të dhëna për sistemin e billingut;
- f) kontratën tip të pajtimit (termat dhe kushtet e përgjithshme);
- g) formulari i aplikimit për caktimin e Kodit NSPC (Sipas kërkesave të pikës C1 të këtij formulari);
- h) formulari i aplikimit për caktimin e Kodit ISPC. (Sipas kërkesave të pikës C1 të këtij formulari);
- i) të tjera.

Personi (juridik/fizik) është dakord që adresa dhe kontaktet e tij të publikohet në Regjistrin Zyrtar të Ofruesve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike

A. RRJETE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

1. Rrjete publike tokësore fikse

☐ Rrjete publike fikse	1.1. Zona e ofrimit	☐ Bashkitë, ☐ Komunat, ☐ Rrugë nacionale, ☐ Rruge dytësore, ☐ Të tjera (specifikoji) _____	
	1.2. Rrjeti i aksesit	☐ Përcjellësa metalike	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
		☐ Kabëll koaksial	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
		☐ Fiber optike	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
		☐ Radio	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
	1.3. Rrjeti i transmetimit	☐ Përcjellësa metalikë	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
		☐ Kabëll Koaksial	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
		☐ Fibër optike	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
		☐ Radio	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
	1.4. Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit	☐ Telefoni fikse	
		☐ Linja me qera	☐ Programe audiovizuale ☐ Komunikime elektronike
		☐ Transmetim të dhënash, ☐ Akses Interneti, ☐ Shërbime të tjera (specifikoji).	

1.5. Brezi i frekuencave në të cilin operojnë radio segmentet e rrjetit:

Rrjeti i aksesit:.....

Rrjeti i transportit:.....

1.6. Faza e ofrimit:

☐ Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti)

☐ Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)

2. Rrjete publike tokësore të lëvizshëm

2.1. ☐ Rrjete të lëvizshme	2.1.1. Llojet	☐ GSM 900 ☐ GSM 1800 ☐ CDMA ☐ 3G (IMT2000/UMTS) ☐ 3.5G ☐ 4G LTE ☐ Të tjera (specifikoji)		
	2.1.1. Zona e ofrimit	☐ Kombëtare ☐ Bashkitë, ☐ Komunitat, ☐ Rrugë nacionale, ☐ Rrugë dytësore, ☐ Të tjera (specifikoji) _____		
	2.1.2. Rrjeti i Transmetimit	☐ Përcjellësa metalike	☐ i veti	☐ marrë me qira (nga)
		☐ Kabëll Koaksial	☐ i veti	☐ marrë me qira (nga)
☐ Fibër Optike		☐ i veti	☐ marrë me qira (nga)	
☐ Radio		☐ i veti	☐ marrë me qira (nga)	
	2.1.3. Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit	☐ Zë ☐ Transmetim të dhënash, ☐ Akses Interneti, ☐ Shërbime të tjera (specifikoji).		
2.1.4. Brezi i frekuencave në të cilin operon rrjeti i transmetimit radio në (MHz ose GHz):				
2.1.5. Faza e ofrimit:				
☐ Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) ☐ Rrjet funksionues Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)				

2.2. ☐ Rrjetet e radio mesazheve (p.sh. radiopaging)	2.2.1. Zona e ofrimit	Kombëtare, Komunitat, Bashkitë, Rrugët, etj		
	2.2.2. Rrjeti transmetues	☐ Përcjellësa metalike	☐ i veti	☐ marrë me qira (nga)
		☐ Kabëll Koaksial	☐ i veti	☐ marrë me qira (nga)
		☐ Fibër optike	☐ i veti	☐ marrë me qira (nga)
☐ Radio		☐ i veti	☐ marrë me qira (nga)	
	2.2.3. Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit.	☐ Tekst njëdrejtimësh ☐ Tekst dydrejtimësh ☐ Posta zanore		
2.2.4. Brezi i frekuencave në të cilin punon operatori:				
2.2.5. Faza e ofrimit:				
☐ Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) ☐ Rrjet funksionues Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)				



3. Rrjete publike me transmetim satelitor

3.1. ☐ Rrjete fikse (pajisje terminal VSAT)	3.1.1. Brezi i frekuencave në të cilin funksionon	☐ Downlink (descending link) Frekuenca e punës
		☐ Uplink (ascending link) Frekuenca e punës
3.1.2. Operatori i segmentit hapësinor:		
3.1.3. Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit.	☐ Zë	
	☐ Dhënia me qira e segmentit hapësinor	☐ përdoruesve ☐ përdoruesve fundore ☐ përdoruesve të tjerë të segmentit hapësinor
	☐ Transportimi i programeve audiovizuale	
	☐ Transmetim të dhënash, ☐ Akses interneti, ☐ Shërbime të tjera (specifikoji).	
3.1.4. Stacion koordinues në Shqipëri:	☐ Jo ☐ Po. Vendndodhja..... Kordinatat gjeografike	
3.1.5. Faza e ofrimit: ☐ Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) ☐ Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		

3.2. ☐ Rrjete të levizshëm (S-PCS, GMPCS, LOS, etc)	3.2.1. Brezi i frekuencave në të cilin funksionon	☐ Downlink (descending link) Frekuenca e punës
		☐ Uplink (ascending link) Frekuenca e punës
3.2.2. Operatori i segmentit hapësinor:		
3.2.3. Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit.	☐ Zë	
	☐ Transmetim të dhënash	
3.2.4. Stacion koordinues në Shqipëri:	☐ Jo ☐ Po. Vendndodhja..... Kordinatat gjeografike	
3.2.5. Faza e ofrimit: ☐ Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) ☐ Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		

B. RRJETE QË PËRDORIN FREKUENCA RADIO

B1. ☐ Rrjete fikse		
1.1. Brezi i frekuencave në të cilin operon rrjeti		
1.2. Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit.	☐ Zë	
	☐ Transmetim të dhënash ☐ Ritransmetim i programeve audiovizuale	
1.3. Rrjeti është i lidhur me rrjetin publik të komunikimeve elektronike	☐ Po ☐ Jo	
1.4. Faza e ofrimit: ☐ Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) ☐ Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		



B2. ☐ Rrjetet Radiopaging	2.1. Zona e ofrimit		
	2.2. Rrjeti transmetues	☐ Përcjellësa metalike	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
		☐ Kabëll Koaksial	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
		☐ Fibër optike	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
		☐ Radio support	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)
	☐ Optical support	☐ i veti ☐ marrë me qira (nga)	
	2.3. Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit.	☐ Tekst njëdrejtimesh ☐ Tekst dydrejtimesh ☐ Posta zanore	
2.4. Brezi i frekuencave në të cilin radio segmenti i aksesit të rrjetit operon:			
2.5. Rrjeti është i lidhur me rrjetin publik të komunikimeve elektronike		☐ Po ☐ Jo	
2.6. Faza e ofrimit: ☐ Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) ☐ Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)			

B3. ☐ Rrjete satelitore fikse (pajisje terminal VSAT)	3.1. Brezi i frekuencave në të cilin ai operon:	☐ Downlink (descending link) Frekuenca e punës
		☐ Uplink (ascending link) Frekuenca e punës
3.2. Operatori i segmentit hapësinor:		
3.3 Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit.	☐ Zë	
	☐ Dhënia me qira e segmentit hapësinor	☐ përdoruesve ☐ përdoruesve fundore ☐ përdoruesve të tjerë të segmentit hapësinor
	☐ Transportimi i programeve audiovizuale	
	☐ Transmetim të dhënash, ☐ Akses interneti, ☐ Shërbime të tjera (specifikoji).	
3.4. Stacion koordinues në Shqipëri:	☐ Jo ☐ Po. Vendndodhja: Kordinatat gjeografike	
3.5. Rrjeti është i lidhur me rrjetin publik të komunikimeve elektronike	☐ Po ☐ Jo	
3.6. Faza e ofrimit: ☐ Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) ☐ Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		



B4. ☐ Rrjetet e lëvizshme (S-PCS, GMPCS, LOS, etc)	4.1. Brezi i frekuencave në të cilin ai operon:	☐ Downlink (descending link) Brezi i frekuencave
		☐ Uplink (ascending link) Brezi i frekuencave
4.2. Operatori i segmentit hapësinor:		
4.3. Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është i lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit.	☐ Zë ☐ Transmetim të dhënash	
4.4. Stacion koordinues në Shqipëri:	☐ Jo ☐ Po. Vendndodhja: Kordinatat gjeografike	
4.5. Rrjeti është i lidhur me rrjetin publik të komunikimeve elektronike	☐ Po ☐ Jo	
4.6. Faza e ofrimit: ☐ Rrjet jo funksionues (në ndërtim). Koha e parashikuar për përfundim të ndërtimit (data/muaji/viti) ☐ Rrjet funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		

B5. ☐ Llojet të tjera të rrjetit
Për t'u plotësuar me të dhënat përkatëse, sipas rastit.



C. SHËRBIME PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

1. Shërbime telefonike

1.1 ☐ Shërbime telefonike të ofruara me anë të rrjeteve publike fikse	1.1.1. Karakteristika të shërbimit	☐ Telefona publike me pagesë	☐ Thirrje lokale ☐ Thirrje kombëtare ☐ Thirrje ndërkombëtare	☐ Tranzit kombëtar ☐ Tranzit ndërkombëtar ☐ Të dhëna mbi tipin e sinjalizimit ☐ SS7 ☐ SIP ☐ H323 etj) ☐ Të tjera (.....) ☐ Të dhëna të Pikës Kombëtare të Sinjalizimit (NSPC) ☐ Kodi NSPC (.....) ☐ Të dhëna të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC) ☐ Kodi ISPC (.....) ☐ Kodi i pikës së Sinjalizimit në distancë (.....) ☐ Të tjera (.....)
	1.1.2. Shërbime të tjera	☐ Faks ☐ Posta zanore ☐ Kujdesi për klientin	☐ Numeratori telefonik ☐ Shërbime të tjera (specifikoji)	
	1.1.3. Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi (zona e ofrimit të shërbimit) ☐ Rrjete të veta: ☐ Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar			
	1.1.4. Faza e ofrimit të shërbimit: ☐ Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti) ☐ Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)			



1.2. ☐ Shërbime telefonike të ofruara me anë të rrjeteve publike tokësore të lëvizshme

1.2.1. Llojet e shërbimeve të ofruara

- ☐ Zë
☐ Faks dhe
☐ Transmetim të dhënash

- ☐ Transit kombëtar
☐ Transit ndërkombëtar

☐ Të dhëna mbi
Tipin e sinjalizimit

- ☐ SS7
☐ SIP
☐ H323 etj)

☐ Të tjera (.....)

☐ Të dhëna të Pikës
Kombëtare
të Sinjalizimit (NSPC)

☐ Kodi NSPC (.....)

☐ Të dhëna të Pikës
Ndërkombëtare
të Sinjalizimit (ISPC)

☐ Kodi ISPC (.....)

☐ Kodi i pikës së
Sinjalizimit në distancë
(.....)

☐ Të tjera (.....)

1.2.2. Shërbime të tjera
(specifikoji)

- ☐ Faks
☐ Posta zanore
☐ Kujdesi për klientin
☐ Roaming

☐ Numeratori telefonik
☐ Shërbime të tjera
(specifikoji)

1.2.3. . Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi (zona e ofrimit të shërbimit)

☐ Rrjete të veta:

☐ Rrjete të cilat janë prone e të tretëve të autorizuar

1.2.4. Faza e ofrimit të shërbimit:

- ☐ Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit
- ☐ Shërbim funksionues



1.3. ☐ Shërbime telefonike të ofruara me anë të rrjeteve publike me transmetim satelitor	1.3.1. Llojet e shërbimeve të ofruara	
	1.3.2. Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi	1.3.2.1. ☐ Rrjete fikse ☐ Rrjete të veta: ☐ Rrjete të cilat janë pronë e të treteve të autorizuar
		1.3.2.2. ☐ Rrjete të lëvizshëm ☐ Rrjete të veta: ☐ Rrjete të cilat janë pronë e të treteve të autorizuar
1.3.3. Faza e ofrimit: ☐ Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti) ☐ Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		

1.4. ☐ Shërbimet e bartesit Kombëtar dhe Nderkombëtar	1.4.1. Mënyra e aksesit	☐ Zgjedhja ☐ Parazgjedhja ☐ Direkt (midis ofruesve të rrjetit)
	1.4.2. Teknologjitë e transportimit	☐ Qarqe të mbyllur ☐ Qarqe të hapura (komutuar) ☐ Paketa
	1.4.3. Të dhënat e pikës së Interkoneksionit	1.4.3.1 ☐ PSTN 1.4.3.2 ☐ Interkoneksion Internet ☐ Peering ☐ Tranzit ☐ Interkoneksion Ndërkombëtar VoIP
	1.4.4. ☐ Të dhëna mbi Sinjalizimin	1.4.4.1 ☐ Të dhëna mbi Tipin e sinjalizimit ☐ SS7 ☐ SIP ☐ H323 etj) ☐ Të tjera..... ☐ Të dhëna të Pikës Kombëtare të Sinjalizimit (NSPC) ☐ Kodi NSPC (.....) ☐ Të dhëna të Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit (ISPC) ☐ Kodi ISPC (.....) ☐ Kodi i pikës së sinjalizimit në distancë (.....) ☐ Të tjera.....



1.5 ☐ **Shërbimet me
vlerë të shtuar**

☐ Tipi i shërbimit

- ☐ Zë
- ☐ Data
- ☐ mesazh zanor/jozanor

☐ Protokolli

- ☐ Të tjera.....
- ☐ Short message peer-to-peer protocol
- ☐ Short message service center

☐ Tipi i rrjetit ku
ofrohet shërbimi

- ☐ Fiks
- ☐ I lëvizshëm
- ☐ Të tjera

☐ 2. Shërbimet e linjave me qira

2.1. ☐ Llojet e linjave me qira	2.1.1. ☐ Analog	☐ Cilësi normale ☐ Cilësi speciale
	2.1.2. ☐ Dixhital	☐ 64 Kbit/s ☐ n x 64 Kbit/s ☐ 2048 Kbit/s digital unstructured ☐ 2048 Kbit/s digital structured ☐ >2048 Kbit/s ☐ emulated (e.g. PVC, SPVC etc.) ☐ Lloje të tjera (specifikoji)
2.1.3. Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi (zona e ofrimit të shërbimit) ☐ Rrjete të veta: ☐ Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar		
2.1.4. Faza e ofrimit: ☐ Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti) ☐ Shërbim funksionues. Koha e venies në funksionim (data/muaji/viti)		

☐ 3. Shërbime të tjera të komunikimeve elektronike

3.1. ☐ Shërbimet e transmetimit të të dhënave	3.1.1. Llojet e aksesit	☐ Në vendndodhje fikse ☐ Të lëvizshëm ☐ Lëvizshmëri e ulet
	3.1.2. Llojet e shërbimeve:	☐ VoIP ☐ SMS ☐ MMS ☐ Band Allotment: ☐ Fikse ☐ Broadband (>128Kbit/s) ☐ Me kërkesë ☐ Minimumi i garantuar ☐ Të tjera (specifikoji)
	3.1.3. Protokollet dhe teknologjitë e përdorura:	☐ SDH/PDH ☐ TCP/IP ☐ Frame relay ☐ HSCSD ☐ EDGE ☐ xDSL ☐ VPN ☐ Powerline ☐ ISDN ☐ ATM ☐ X.25 ☐ GPRS ☐ 3G (IMT 2000/UMTS) 3.5G 4G ☐ Cable modem ☐ Ethernet ☐ MPLS-TP ☐ Të tjera (specifikoji)
3.1.4. Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi (zona e ofrimit të shërbimit) ☐ Rrjete të veta: ☐ Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar.....		
3.1.5. Faza e ofrimit: ☐ Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti) ☐ Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)		



3.2. ☐ Ofrimi i shërbimit të aksesit në Internet

3.2.1. Mënyrat e lidhjes me përdoruesin fundor

- ☐ Dial-up
- ☐ Linjë e dedikuar
- ☐ Kabëll Koaksial
- ☐ Përcjellësa metalike
- ☐ Radio
- ☐ Fibër optike
- ☐ Satelit
- ☐ Të tjera (specifikoji)

3.2.2. Llojet e furnizimit me akses

☐ Broadband (>128Kbit/s)

- ☐ Dial-up
- ☐ Linjë e dedikuar
- ☐ Kabëll Koaksial
- ☐ Përcjellësa metalike
- ☐ Radio
- ☐ Fibër optike
- ☐ Satellite
- ☐ Të tjera (specifikoji)

3.2.3. Mënyrat e lidhjes ndërkombëtare

3.2.3.1. ☐ Akses direkt

- ☐ Fiber Optike (kapaciteti për t'u plotësuar).....
- ☐ Satelitor (kapaciteti për t'u plotësuar).....
- ☐ Linja me qira (kapaciteti për t'u plotësuar).....
- ☐ Lidhje fikse radio (kapaciteti për t'u plotësuar).....
- ☐ Të tjera (specifikoji)

3.2.3.2. ☐ Akses indirekt (shpjego mënyrën)

3.2.4. Faza e ofrimit:

- ☐ Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti)
- ☐ Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)

3.3. ☐ Shërbim Radiopaging

3.3.1. Rrjete me anë të të cilave ofrohet shërbimi (zona e ofrimit të shërbimit)

- ☐ Rrjete të veta:
- ☐ Rrjete të cilat janë pronë e të tretëve të autorizuar.....

3.3.2. Faza e ofrimit:

- ☐ Shërbim jo funksionues. Koha e parashikuar për fillimin e ofrimit (data/muaji/viti)
- ☐ Shërbim funksionues. Koha e vënies në funksionim (data/muaji/viti)

4. ☐ Lloje të tjera të shërbimeve

Për t'u plotësuar me të dhënat përkatëse, sipas rastit:



PARAQITJA E DETYRIMEVE LIGJORE

- ☐ Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se do të ushtroj aktivitet në fushën e komunikimeve elektronike të shënuara më sipër dhe aplikoj për regjistrim në regjistrin e ofrueseve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (sipërmarrësve) të AKEP.
- ☐ Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam mbyllur aktivitetet e komunikimeve elektronike të shënuara më sipër.
- ☐ Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam mbyllur çdo aktivitet të komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të përgjithëm.
- ☐ Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se të dhënat e mia kanë pësuar ndryshime, sikurse përshkruhen në formular.
- ☐ Unë nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se kam ndryshuar formën ligjore të kompanisë sime sic përshkruhet në formular. Emri i vjetër është si më poshtë:

Unë nëpërmjet këtij dokumenti paraqes në AKEP të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe/ose të gjithë dokumentat që sigurojnë se nënshkruesi i këtij Njoftimi Regjistrimi ka lidhje me personin përfaqësues.

Unë deklaroj se informacioni që perfsihet në deklarin e paraqitur, sikurse çdo informacion tjetër shoqërues, është i saktë dhe i vërtetë, dhe jam plotësisht i vetëdijshëm për faktin që, lidhur me angazhimin në çdo aktivitet të komunikimeve elektronike për të cilin është e nevojshme të sigurosh të drejtën e përdorimit për numeracion dhe frekuenca, të drejta të cilat nuk sigurohen nëpërmjet kësaj procedurë, unë duhet të paraqes një aplikim për të fituar të drejtat e përdorimit të cituara më sipër përpara fillimit të ofrimit të shërbimit.

Data e Aplikimit: / /

Nënshkrimi dhe Vula

Vendi:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ÇERTIFIKATË
E KONFIRMIMIT TË NJOFTIMIT

Nr.____/datë____.____.____

SIPËRMARRËSI “XXXXXXXXXX”

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare konfirmon se sipërmarrësi “XXXXXXXXXX” me adresë: XXXXXX, ka paraqitur Njoftimin e Regjistrimit sipas Nenit 14 të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe është regjistruar në Regjistrin e sipërmarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm:

1. Rrjete publike të komunikimeve elektronike:
 - a)
 -
2. Shërbime publike të komunikimeve elektronike:
 - a)
 -

Sipërmarrësi i regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të mësipërme, i cili operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, është i detyruar të zbatojë termat dhe kushtet e parashtruara në Aneksin C të Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm.

Në faqen e internetit AKEP publikon një regjistër i përditësuar i të gjithë sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke përfshirë informacionin mbi llojet e rrjeteve dhe shërbimeve që ata ofrojnë.

K R Y E T A R I

(nënshkrimi & vula e autoritetit)

ANEKS C

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË OFRIMIT TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE NË REGJIMIN E AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

Në zbatim të nenit 15 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**), për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve publike në Republikën e Shqipërisë, nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm AKEP vendos këto,

KUSHTE TË PËRGJITHSHME:

1. Pajisja me Autorizime

Subjektet (personat fizikë ose juridikë) që dëshirojnë të ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë nuk mund të fillojnë aktivitetin/et pa u pajisur më parë nga AKEP-i me autorizimet e nevojshme sipas ligjit nr. 9918, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe kësaj rregulloreje.

AKEP-i autorizon ushtrimin e aktivitetit për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm nëpërmjet lëshimit të:

Çertifikatës së Konfirmimit të Njoftimit;

Autorizimit Individual për caktimin dhe përdorimin e frekuencave;

Autorizim Individual për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike.

2. Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit

Përpara fillimit të ushtrimit të një aktiviteti në fushën e komunikimeve elektronike që lidhet me ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, subjekti i interesuar aplikon *on-line* sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore për Njoftimin e AKEP-it dhe regjistrimin në regjistrin (*data-bazë*) e përditësuar të tij për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm.

AKEP-i sipas procedurës së përcaktuar në rregullore bën regjistrimin e Njoftimit dhe lëshon Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit.

3. Përdorimi i frekuencave

Në rast se sipërmarrësi për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike elektronike do të përdori frekuenca, atëherë së bashku me njoftimin për regjistrim duhet të aplikojë edhe për pajisjen me Autorizim Individual për caktimin dhe përdorimin e frekuencave.

Dhënia e së drejtës për përdorim të frekuencave, bëhet nga AKEP-i sipas Rregullores Nr. 4, datë 04. 11. 2008 “ Për Autorizimin Individual”. Sipërmarrësi për pajisjen me Autorizim Individual për caktimin dhe përdorimin e frekuencave aplikon në AKEP sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren Nr. 4, datë 04. 11. 2008 “ Për Autorizimin Individual”.

Cilido sipërmarrës i pajisur me Autorizim Individual për caktimin dhe përdorimin e frekuencave:

është i detyruar të zbatojë dispozitat e përcaktuara në ligjin nr. 9918, aktet nënligjore në zbatim të tij, Planin Kombëtar të Radiofrekuencave, Rregulloren Nr. 4, datë 04. 11. 2008 “Për autorizimin Individual”, si dhe çdo akti tjetër që amendon, apo zëvendëson këto rregullore;

nuk ka të drejtë të përdori frekuenca të pa përcaktuara në Autorizimin Individual, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në ligjin nr. 9918 dhe Rregulloret referuese;

është i detyruar t’i përdorë frekuencat apo brezat e frekuencave të caktuara në Autorizimin Individual vetëm për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve për të cilat i janë caktuar;

pranon që, për përdorimin e frekuencave për të cilat nuk kërkohet miratim paraprak nga AKEP, nuk i garantohet asnjë mbrojtje ndaj çfarëdo interference të mundshme dhe se nuk është i lejuar t’i përdori frekuencat e sipërpërmendura për të shkaktuar interferencë tek stacionet e tjera të radiokomunikacioneve. Nëqoftëse konstatohet se si rezultat i mos zbatimit të kushteve dhe specifikimeve të dhëna këtu apo si rezultat i keqfunksionimit të pajisjeve të përdorura janë shkaktuar interferenca të dëmshme tek stacionet e radiokomunikimit të tjerëve, është i detyruar të ndalojë menjëherë përdorimin e tyre.

Nuk mund të transferojë tek të tretët frekuencat e caktuara për përdorim në Autorizimin Individual, pa miratimin paraprak të AKEP-it.

4. Përdorimi i numeracionit dhe serive numerike

Në rast se sipërmarrësi për ofrimin e rrjeteve dhe ose shërbimeve elektronike publike do të përdorë numra dhe seri numerike, atëhere sëbashku me njoftimin për regjistrim duhet të aplikojë në AKEP-i sipas dhe Rregulloren Nr. 10, datë 11. 08. 2009 “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”, (*miratuar me VKD Nr.932, datë 11.08.2009*). Numrat dhe seritë numerike mund të përdoren nga sipërmarrësit vetëm pas caktimit të tyre nga AKEP-i.

Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, për përdorimin e numrave dhe serive numerike duhet të zbatojë çdo dispozitë të parashikuar në Planin Kombëtar të Numeracionit, si dhe çdo akt tjetër që amendon,ose zëvendëson atë në përputhje me ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren Nr. 10, datë 11. 08. 2009 “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”.

Cilido sipërmarrës i pajisur nga AKEP-i me numra dhe seri numerike, kërkohet:

të përdorë numrat e caktuar nga AKEP në përputhje me kushtet e vendosura në vendimet përkatëse të AKEP-it, Planin Kombëtar të Numeracionit dhe dispozitat e këtij Aneksi;

të sigurojë përdorimin korrekt dhe efektiv të numrave dhe grupeve të numrave që i janë caktuar;
të mos bëjë diskriminime të pajustificuara lidhur me sekuencën e numrave dhe grupeve të numrave ndërmjet pajtimtarëve.

Numrat dhe grupet e numrave të caktuar nga AKEP-i nuk mund t'i transferohen të treta pa miratimin paraprak të AKEP-it. Sipërmarrësit për numrat dhe seritë numerike të caktuara në përdorim nga AKEP-i, nuk mund të vendosin asnjë të drejtë pronësie.

5. Caktimi i kodeve të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC)

Cilido sipërmarrës që kërkon të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike përpara fillimit të ofrimit të tyre, për realizimin e interkoneksionit duhet të pajiset me NSPC dhe nëse do të ofrojë shërbimin e tranzitit ndërkombëtar atëhere duhet detyrimisht të pajiset edhe me ISPC. Caktimi nga AKEP-i i NSPC dhe ISPC bëhet mbi bazën e rregullave të përcaktuara në (Akt Nr. 17. Datë 16. 04. 2010) **“Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”**.

Për caktimin e NSPC dhe ISPC nga AKEP-i, sipërmarrësi duhet të aplikojë sipas (Akt Nr. 17. Datë 16. 04. 2010) **“Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”** njëkohësisht me fillimin e aplikimit për Njoftim regjistrimi përcaktuar në këtë rregullore. Për caktimin e ISPC sipërmarrësi përpara fillimit të aplikimit duhet të ketë siguruar dhe disponojë një marrëveshje paraprake me operatorin/t ndërkombëtarë ku të jetë vendosur edhe ISPC që disponon ky operator ndërkombëtar.

Sipërmarrësit e pajisur nga AKEP-i me NSPC dhe ISPC, duhet:

të përdorin kodet e caktuar nga AKEP në përputhje me kushtet e vendosura në vendimet përkatëse të AKEP-it, Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”, dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.

6. Dhënia e Informacionit për AKEP-in

a) Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit elektronik është i detyruar që me paraqitjen e një kërkesë nga AKEP-i, brenda afatit kohor të përcaktuar, të sigurojë dhe japë informacionin me të dhënat e kërkuara. Lloji i të dhënave, afatet dhe mënyra e dërgimit të tyre përcaktohet nga AKEP.

b) Çdo dokument ose informacion që i jepet AKEP-it nga një sipërmarrës sipas këtij përcaktimi ose ndonjë përcaktimi tjetër në këtë Rregullore, do të konsiderohet si konfidencial kur nëpërmjet arsyetimit të dokumentuar dhe bazuar ligjërisht, kërkohet të trajtohet si i tillë.

7. Ndërtimi dhe përdorimi i faciliteteve

a) Ndërtimi dhe përdorimi i faciliteteve nga një sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, është objekt i zbatimit të detyrueshëm të legjislacionit lidhur me planifikimin territorial, aksesit në pronat e patundshme, planeve rregulluese të njësive vendore dhe rregullave apo akteve rregullatore kombëtare apo lokale për këtë qëllim, legjislacionit për mbrojtjen e ambientit dhe mbrojtjen nga rrezatimet dhe pajtueshmërinë elektromagnetike, legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit, për sigurinë e përdoruesve etj, me përjashtim të rastit kur përcaktohet ndryshe në ligjin nr.9918, apo ligje të tjera të zbatueshëm.

b) Çdo sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike:

është përgjegjës për të marrë çdo masë të nevojshme dhe çdo leje të kërkuar për ndërtimin dhe përdorimin e faciliteteve të nevojshme për funksionimin efektiv të Rrjeteve apo Shërbimeve që ai ofron;

do të kryejë punime periodike të mirëmbajtjes së pajisjeve të komunikimit elektronik që ai përdor, në mënyrë që të sigurojë që këto pajisje dhe facilitete të mos i shkaktojnë asnjë dëm personave apo pronës së të tjerëve;

do të shqyrtojë dhe investigojë me përgjegjësi çdo raport mbi rrezikun e shkaktuar nga çfarëdo pajisje të komunikimit elektronik apo facilitet, kudo që ato të jenë vendosur dhe do të shmangë çdo rrezik të mundshëm.

8. Detyrime lidhur me ofrimin e rrjeteve pa tela.

Dispozitat e mëposhtme janë pjesë e detyrimeve që duhet të zbatojnë sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike duke përdorur radiofrekuenca, pavarësisht nëse ato i ofrohen publikut apo jo.

Çdo sipërmarrës që punon nën regjimin e autorizimit të përgjithshëm dhe përdor radiofrekuenca është i detyruar të zbatojë dispozitat e mëposhtme.

8.1 Shmangia e Interferencave

Çdo sipërmarrës,

a) është i detyruar të përdori gjatë ndërtimit të rrjetit dhe ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, pajisje radio të prodhuara në mënyrë të tillë që të lejojnë përdorim efektiv të spektrit që i është caktuar, me qëllim që të shmangi çdo interferencë të dëmshme.

b) është i detyruar të bashkëpunojë me cilindo sipërmarrës tjetër që përdor radiofrekuenca të caktuara nga AKEP-i, në mënyrë që të eliminohet çdo interferencë e dëmshme që mund të preki cilësinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike që i ofrohen përdoruesve, ose të eliminojë çdo interferencë të dëmshme që mund t'ju jetë shkaktuar stacioneve të radiokomunikimit që operojnë në mënyre legale brenda territorit të Shqipërisë ose në vendet fqinje.

Nëqoftëse AKEP konstaton se një interferencë e dëmshme është shkaktuar tek stacionet e radiokomunikimit ose përdoruesit për shkak të moszbatimit të kushteve dhe specifikimeve të frekuencave të caktuara, ose për shkak të keqfunksionimit të pajisjeve të tij, sipërmarrësi është i detyruar të ndërpresë funksionimin e sistemit të tij, menjëherë pas marrjes së njoftimit. Në rast të kundërt, ndaj tij aplikohen sanksionet e parashikuara nga ligji nr.9918.

8.2 Instalimi i pajisjeve radio

a) Cilido sipërmarrës është i detyruar të zbatojë standardet e pajisjeve të përcaktuara nga autoritetet kompetente shqiptare dhe ETSI në lidhje me këto pajisje, si dhe kriteret përkatëse të përcaktuara nga AKEP-i lidhur me karakteristikat e transmetimit, në mënyrë të tillë që të sigurojë bashkëzistencën efektive dhe të harmonizuar të të gjithë aplikimeve të telekomunikacioneve pa tela në të njëjtën frekuencë apo në frekuenca fqinje. Sipërmarrësi duhet të zbatojë kushtet teknike të vendosura në autorizimin individual me të cilin është pajisur.

b) Cilido sipërmarrës duhet të sigurojë që rrjeti i tij është projektuar, instaluar, mirëmbajtur dhe funksionon në mënyrë të tillë që të mos shkaktojë çfarëdo interference të dëmshme ndaj sipërmarrësve të tjerë ose përdoruesve të ligjshëm të spektrit të frekuencave.

9. Detyrime lidhur me ofrimin e rrjeteve dhe/ose ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike

9.1 Cilido sipërmarrës që operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike është i detyruar të marrë masa gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura, drejtpërdrejt ose nëpërmjet personave të tretë, në mënyrë që të garantojë:

- a) Sigurinë, integritetin dhe mirëmbajtjen e funksioneve të rrjeteve të komunikimit elektronik të përdorur dhe/ose të kontrolluar nga një sipërmarrës i caktuar, si dhe sigurinë, integritetin dhe mirëmbajtjen e cdo rrjeti tjetër të komunikimeve elektronike që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm brënda shkallës së kontrollit nga sipërmarrësi në fjalë. Në mënyrë të vecantë, çdo sipërmarrës që ofron rrjete të telefonisë publike fikse është i detyruar të marrë gjithë masat e nevojshme për të siguruar integritetin e rrjetit.
- b) Ndërveprimin e shërbimeve të ofruara nga sipërmarrësi me shërbimet korresponduese të ofruara nga sipërmarrës të tjerë.
- c) Mbrotjtjen e të dhënave personale në masën që është brënda kontrollit të tij, si dhe zbatimin e çdo dispozite në fuqi lidhur me mbrotjtjen e të dhënave personale, konfidencialitetit të komunikimeve dhe mbrotjtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike.
- d) Fshtësinë e komunikimeve.

- e) Lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për përgjimin e telekomunikimeve dhe zbatimin e detyrimeve, që burojnë nga ky legjislacion.
- f) Kushtet për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në rastet e gjendjes së emergjencës apo të gjendjes së luftës.
- g) Mbrojtjen e shtetasve ndaj veprimeve të dëmshme të rrezatimit elektromagnetik, të përhapur nga rrjetet e komunikimeve elektronike;
- h) Mbrojtjen e konkurrencës.
- i) Mbrojtjen e ambientit dhe të planit rregullues të njesise vendore, si dhe përdorimin efektiv të radiofrekuencave.
- j)

9.2 Cilido sipërmarrës që ofron shërbime publike telefonike është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të sigurojë akses pa pengesë në shërbimet e emergjencës.

10. Shërbimi Universal

Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike zbaton të gjitha detyrimet që mund t'i vendosen lidhur me ofrimin e shërbimit universal si rrjedhojë e zbatimit të ligjit në fuqi për komunikimet elektronike.

11. Detyrimet dhe masat rregullatore si sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT)

Çdo sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike i vlerësuar nga AKEP-i mbi bazën e analizës së tregut, si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg, është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet që AKEP-i vendos në zbatim të ligjit nr. 9918 dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

12. Përdorimi i Përbashkët i Faciliteteve

a) Një sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit elektronik ka të drejtë të realizojë kontrata për përdorimin e përbashkët të pajisjeve dhe/ose faciliteteve me sipërmarrës të tjerë që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike. Veçanërisht, në rastet kur një sipërmarrësi i refuzohet aksesit si rezultat i nevojës për mbrojtjen e ambientit, shëndetit publik, sigurisë publike, ose dëmtimit të planit rregullues të njësisë vendore, pas kërkesave të bëra nga ky sipërmarrës, AKEP mund të detyrojë një ofrues tjetër të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike të lejojë përdorimin e përbashkët të një faciliteti specifik ose pronë të patundshme, duke përfshirë edhe vetë godinën.

b) Ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë të detyruar të zbatojnë urdhërat dhe rregulloret përkatëse të nxjerra nga AKEP lidhur me çështjen e përdorimit të përbashkët të faciliteteve.

13. Ndërveprimi i shërbimeve dhe Interkoneksioni i Rrjeteve

- a) Cilido sipërmarrës i autorizuar nga AKEP-i për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike ka të drejtë të negociojë interkoneksionin dhe të marrë akses ose të interkonektohet me sipërmarrës të tjerë që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm.
- b) Procedura dhe rregullat për aksesin dhe interkoneksionin zbatohen nga sipërmarrësit në përputhje të plotë me ligjin nr. 9918 dhe dokumentat rregullatore të nxjerra dhe miratuara nga AKEP-i:
 - i) Rregullore Nr. 19, datë 14. 06. 2010 “Për aksesin dhe interkoneksionin”;
 - ii) RIO e publikuar e operatorëve me FNT;
 - iii) RUO e publikuar e operatorëve me FNT.
 - iv) çdo vendim i AKEP-it i nxjerrë për këtë qëllim.
- c) Për realizimin e interkoneksionit dhe/ose aksesit sipërmarrësit lidhin midis tyre marrëveshje interkoneksioni dhe/ose aksesit, një kopje e të cilave depozitohet në AKEP.
- d) Në çdo rast, marrëveshjet e interkoneksionit dhe aksesit duhet të jenë në përputhje me ligjin nr. 9918, legjislacionin në tërësi dhe aktet e AKEP-it për këtë qëllim.

14. Standardet – Kërkesat teknike

- a) Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të zbatojë standardet dhe kërkesat teknike të administruara nga AKEP si dhe rregulloret përkatëse

- b) **Standartet e aplikuara në Treguesit e Cilësisë së Shërbimit (QoS)**

ETSI EG 202 057

ETSI: EG 202 057-1 V1.1.1(2005-10)

ETSI: EG 202 057-1 V1.2.1(2005-10)

ETSI: EG 202 057-2 V1.2.1(2005-10)

ETSI: EG 202 057-3 V1.1.1(2005-04)

ETSI: EG 202 057-4 V1.1.1(2005-10)

ETSI EG 201 769.

ETSI EG 201 769-1.

ETSI EG 201 769-1 V1.1.2 (2000-10);

ETSI TR 101 949

ETSI TS 102 250-5

ETSI-Specifikime Teknike-TS 102 250-6.

Rregullore Nr. 16, datë 16. 04. 2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimeve”;
Rregullore Nr. 22, datë 24. 06. 2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrbane të komunikimeve elektronike”.

15. Publikimi i Specifikimeve të Ndërfaqeve

Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike është i detyruar të publikojë specifikimet e ndërfaqeve të përdorura për ofrimin e shërbimeve.

16. Pajisjet fundore të telekomunikacionit dhe pajisjet radio

a) Gjithë pajisjet fundore të telekomunikacionit dhe pajisjet radio që përdoren nga një sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të jenë në përputhje me aktet ligjore dhe dispozitat e rregulloreve për këto lloj pajisjesh, që nxirren në përputhje dhe në zbatim të VKM nr.331 dt.14.4.2011 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve””.

b) Një sipërmarrësi nuk i lejohe të vendosë asnjë kusht teknik shtesë përveç atyre të parashikuara në standardet dhe/ose specifikimet përkatëse që kanë të bëjnë me pajisjet fundore të telekomunikacioneve, ose të bëjë diskriminim në trajtimin e pajtimtarëve, me kusht që pajisjet fundore të telekomunikacioneve që ata dëshirojnë të përdorin të plotësojnë kërkesat teknike thelbësore të përcaktuara në VKM nr.331 dt.14.4.2011.

17. Cilësia e shërbimeve të ofruara për përdoruesit

a) Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike janë të detyruar të plotësojnë të gjithë detyrimet lidhur me cilësinë e shërbimeve, në përputhje me ligjin nr. 9918 dhe vendimet e AKEP, për treguesit e cilësisë së shërbimit;

b) Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike janë të detyruar të publikojnë informacion krahasues, të mjaftueshëm dhe të përditësuar lidhur me cilësinë e shërbimeve që i ofrohen përdoruesve fundore.

c) Për të siguruar saktësinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave të ofruara nga sipërmarrësit, AKEP kryen inspektime mbi nivelet e performancës të arritur nga sipërmarrësit.

d) AKEP përshtat aktet rregullatore lidhur me cilësinë e shërbimit në përputhje me rekomandimet dhe standartet ndërkombëtare.

18. Inspektimi

Për kontrollin e zbatueshmërisë së ligjshmërisë dhe kushteve të përcaktuara nga AKEP-i për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, AKEP-i inspekton veprimtarinë e sipërmarrësve në përputhje me ligjin nr. 9918 dhe rregulloren për inspektimin. Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike është i detyruar të lejojë inspektorët e AKEP-it të kryejnë inspektimin kudo ku ka pajisje të komunikimeve elektronike, si dhe t'i ofrojnë inspektorëve të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre.

19. Mbrojtja e Konsumatorit

a) Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të zbatojë detyrimet ligjore lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve . Çdo marrëveshje që sjell kufizime apo eliminim të përgjegjësisë së sipërmarrësit në këtë drejtim konsiderohet e pavlefshme.

c) Sipërmarrësit janë të detyruar të aplikojnë procedura për shqyrtim të menjëhershëm të kërkesave dhe ankesave të bëra nga pajtimtarët/përdoruesit lidhur me instalimin, fillimin, përfundimin, faturimin dhe cilësinë e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve që i ofrohen publikut. Përveç kësaj, sipërmarrësit janë të detyruar të informojnë AKEP, kur kjo gjë kërkohet nga AKEP-i, lidhur me të gjitha kërkesat dhe ankesat e mësipërme të firmosura në mënyrën e duhur dhe që i janë paraqitur ofruesit. Informacioni i mësipërm mund të përfshijë gjithashtu edhe informacionin mbi mënyrën dhe kohën e plotësimit të këtyre kërkesave.

20. Kontratat

20.1 Sipërmarrësit sigurojnë lidhjen ose aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike, në bazë të kontratës që lidhin me pajtimtarët në zbatim të legjislacionit në fuqi. Kushtet e përfshira në Kontratën Tip duhen të jenë sa më qarta, të sakta dhe të thjeshta, në mënyrë të tillë që pajtimtarët të jenë plotësisht të ndërgjegjshëm për të gjitha kushtet kontraktuale.

20.2 Një kontratë e lidhur ndërmjet një pajtimtari dhe një sipërmarrësi që ofron lidhjen dhe/ose aksesin në rrjetin publik telefonik ose ndërmjet një konsumatori dhe një ofruesi shërbimesh të komunikimeve elektronike, duhet të përfshijë detajet minimale që vijnë:

- a) Adresën dhe të dhënat e sipërmarrësit dhe pajtimtarit.
- b) Shërbimet e ofruara, nivelin e cilësisë së këtyre shërbimeve, si dhe kohëzgjatjen e lidhjes fillestare.
- c) Natyrën e mirëmbajtjeve që u bëhen shërbimeve të ofruara.

- ç) Informacion lidhur me tarifat, si dhe mjetet e përdorura për dhënien e informacionit të përditësuar lidhur me gjithë tarifat e zbatueshme dhe pagesat e mirëmbajtjes, (shtuar) si dhe periudhën kohore për njoftimin e çdo ndryshimi të tyre.
- d) Kohëzgjatjen e kontratës, kushtet e rinovimit dhe përfundimit të shërbimeve dhe të kontratës.
- e) Kushtet e zbatueshme për kompensimin dhe rimbursimin nëqoftëse detyrimet kontraktuale lidhur me cilësinë e shërbimit janë shkelur.
- f) Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Nëqoftëse një mosmarrëveshje duhet zgjidhur në rrugë gjyqësore të përcaktohet gjykata kompetente. Gjykata ku banon pajtimtari është ajo që ka juridiksion mbi çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo kontratë.
- g) Të drejtën e pajtimtarit që komunikimet e tij/saj të ruhen si konfidenciale dhe sekrete.
- h) Të drejtën e pajtimtarit që të jetë i lirë të zgjedhë lidhjen në pikën fundore të një rrjeti telefonik fiks dhe përdorimin e pajisjes fundore, me kusht që pajisja e zgjedhur të jetë e përshtatshme për t'u lidhur në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligj.
- i) Kërkesa e përdorimit të gjuhës shqipe për çdo shërbim që kryhet nga sipërmarrësi.
- j) Procedurat në rast të moskryerjes së pagesës apo të kryerjes me vonesë të pagesave për shërbimet.

20.3 Kontrata Tip me pajtimtarin hartohet nga sipërmarrësi dhe miratohet nga AKEP-i. Çdo sipërmarrës që planifikon të ofrojë rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime për publikun është i detyruar që në procesin e aplikimit për regjistrimin e njoftimit të depozitojë në AKEP edhe Kontratën Tip me pajtimtarët që nënkupton një akt juridik standard që rregullon marrëdhëniet e tij me pajtimtarët.

21. Forca Madhore

a) Pa kufizuar dispozitat e këtij dokumenti, një sipërmarrës që ofron rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime për publikun nuk do të konsiderohet se ka thyer rregullat e parashikuara në kuadrin e Autorizimit të Përgjithshëm ose në të drejtat e përdorimit të frekuencave apo të numeracionit që i është caktuar, si rrjedhim i mos përputhjes me kushtet apo si pasojë e mosplotësimit të kushteve për periudhën kohore kur kjo mos përputhje me kushtet ka ardhur për shkak të një Force Madhore.

Me Forcë Madhore nënkuptohet: Luftë (qoftë e shpallur apo jo), rebelime, akte të sabotimit, akte terrorizmi, eksplozione dhe zjarre që nuk kane ardhur si pasojë e neglizhencës së qartë nga ana e ofruesit, embargot dhe grevat.

b) Sipërmarrësi është i detyruar të sigurojë që në rast se ndonjë fatkeqësi ndodh për shkak të Forcës Madhore, të marrë të gjitha masat për të ruajtur disponibilitetin e rrjetit publik të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimeve që i ofrohen publikut dhe mirëmbajtjen e

nivELIT më të lartë të mundshëm të shërbimeve në mënyrë që t'i përgjigjet kërkesave të vendosura nga cilido Autoritet publik.

22. Detyrime për Mbrojtjen Kombëtare dhe Sigurinë e Rendit Publik

- a) Sipërmarrësi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të bashkëpunojë me organet kompetente të përcaktuara në Kushtetutë dhe legjislacionin shqiptar lidhur me mbrojtjen kombëtare dhe çështje të sigurisë publike.
- b) Sipërmarrësit që ofrojnë akses në rrjetet dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, hartojnë dhe paraqesin në AKEP një plan, për të siguruar integritetin e rrjetit të komunikimeve publike dhe akses në shërbimet e komunikimeve publike, të zbatueshëm në situatë të jashtëzakonshme.

Me situatë të jashtëzakonshme kuptojmë dëmtimet e rënda të rrjetit, fatkeqësitë natyrore, gjendjen e emergjencës ose gjendjen e luftës. Plan i siguron akses të pandërprerë dhe përdorimin e numrave të emergjencës.

Sipërmarrësit duhet të zbatojnë masat emergjente përgjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës të jashtëzakonshme.

23. Detyrime të Veçanta për Kategori të Shërbimeve Publike

23.1 Detyrime Shtesë për Ofrimin e Shërbimeve Telefonike Publike

Dispozitat e përfshira në këtë paragraf përmbajnë detyrime shtesë për sipërmarrësit që ofrojnë Shërbime Publike Telefonike. Kështu, cilido sipërmarrës që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe ofron Shërbime Publike Telefonike është i detyruar të zbatojë dispozitat e këtij paragrafi.

23.2 Shërbimet e emergjencës

- a) Ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik duhet t'ju mundësojnë Përdoruesve aksesin në numrin e emergjencës "112", ose numrat e tjerë të emergjencës të përcaktuar në ligj, pa pagesë nga çdo pajisje fundore e pajtimtarëve të telekomunikacioneve dhe/ose telefonat publike.
- b) Ofruesit e Shërbimit Telefonik Publik janë të detyruar të sigurojnë pa pagesë gjithë informacionin e nevojshëm për identifikimin e vendndodhjes së personit që ka thirrur autoritetet kompetente në mënyrë që të veprojnë me emergjencë, për të gjitha thirrjet e bëra në numrin e emergjencës "112".
- c) Ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik që ofrojnë Shërbime të Mesazheve të Shkurta (SMS), në mënyrë që t'u shërbejnë personave që kane probleme serioze me të folurit dhe dëgjimin, janë të detyruar të sigurojnë akses në shërbimet e emergjencës pa pagesë nëpërmjet Shërbimit të Mesazheve të Shkurtra (SMS).

23.3 Numeratori telefonik dhe shërbimet e informacionit

a) Ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik janë të detyruar, përveç dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale:

Të pajisin Pajtimtarët e tyre me Numerator Telefonik.

T'u sigurojë Përdoruesve me akses të paktën një shërbim të kerkimit të informacionit në Numeratorin Telefonik i cili mbulon të gjithë numrat e pajtimtarëve të regjistruar në telefoninë zanore ose fikse dhe komunikimin personal. Nëqoftëse shërbimi i kerkimit të informacionit në Numratorin Telefonik është pjesë e Shërbimit Universal, atëherë ofruesit e shërbimit të telefonisë zanore janë të detyruar t'ju sigurojnë Pajtimtarëve akses në të paktën një shërbim të kerkimit të informacionit në Numratorin Telefonik si pjesë e Shërbimit Universal.

T'ju sigurojë Përdoruesve të të gjithë telefonave të tyre publike, në se kjo është teknikisht e mundur, akses në shërbimet e informacionit që sigurohen nëpërmjet serive 118XX.

b) Gjithë ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik që caktojnë numra telefonikë janë të detyruar të informojnë pajtimtarët e tyre, mbas lidhjes së kontratës përkatëse, duke përfshirë dhe pajtimtarët me kartë të parapaguar të telefonisë së lëvizshme, për (a) qëllimet e numeratorit telefonik të shtypur ose në formë elektronike që i shpërndahen publikut ose mund të merren nëpërmjet shërbimeve të informacionit; (b) të drejtën e tyre për t'u përfshirë në numeratorët telefonikë të disponueshëm për publikun; dhe (c) të drejtën e tyre të kontrollojnë dhe në se është e nevojshme të korrigjojnë ose të kërkojnë fshirjen e të dhënave të tyre nga numeratori. Një pajtimtar ka të drejtë t'i kërkojë operatorit që i ka caktuar numrin e telefonit në se të gjitha ose një pjesë e numrave ose të dhënave personale të tij/saj mund të përfshihen në numeratorin telefonik të disponueshëm për publikun, apo në se një pjesë apo të gjitha të dhënat personale dhe numrat e tij mund të bëhen të disponueshëm për të tretët.

c) Mënyra e përdorur nga pajtimtari, për të shprehur dëshirën e tij mbi atë nëse dëshiron të përfshihet në numeratorin telefonik të operatorit të tij, duhet të jetë në përputhje me kushtet e parashikuara në ligj për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e komunikimeve elektronike.

d) Ofruesit e shërbimit telefonik publik që caktojnë numra telefonikë, përpara se të transferojnë detaje të pajtimtarëve të tyre tek të tretët, janë të detyruar të informojnë pajtimtarët e tyre pa pagesë në se kjo është e mundur, si dhe për personin që do të marrë apo kategorinë e atyre që mund të marrin këtë informacion, si dhe qëllimin e transferimit, i cili nuk mund të jetë i ndryshëm nga ai për të cilin janë marrë këto të dhëna për herë të parë. Në këtë mënyrë pajtimtarët kanë mundësinë të shprehin dëshirën e tyre lidhur me këtë transferim ashtu siç përcaktohet dhe në ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e komunikimeve elektronike.

e) Pajtimtarëve me kartë telefonike të parapaguar ju kërkohet të njoftojnë dëshirën e tyre me shkrim ose në mënyrë elektronike tek operatori i tyre, në se dëshirojnë të përfshihen në numeratorin telefonik apo jo.

f) Çdo ofrues i shërbimit telefonik publik që cakton numra telefonike për pajtimtarët e tij është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë të arsyeshme për sigurimin, brenda kuadrit të ofrimit të numeratorit telefonik dhe informacionit për numrat, e informacionit përkatës në një formë të caktuar dhe në një rrugë që është e qartë, objektive, e paanshme dhe e orientuar në kosto. Detyrimi i mësipërm ka të bëjë veçanërisht me kërkesën e sigurimit të shërbimeve të informacionit për numrat dhe/ose nxjerrjen e numeratorit telefonik dhe, përtej këtij qëllimi, nuk lejohet asnjë akses tjetër në detajet e Përdoruesve, pa lejen e shprehur të tyre. Në se lind një mosmarrëveshje ndërmjet palëve të interesuara lidhur me sa më sipër, cilado palë e interesuar ka të drejtë të ankohet pranë AKEP dhe të kërkojë një investigim lidhur me pajtueshmërinë me kushtet e përcaktuara në këtë paragraf.

g) Ofruesit e shërbimit publik telefonik janë të detyruar të jenë të paanshëm kur përpunojnë dhe paraqesin detajet e Përdoruesve të tyre ose detajet që u bëhen të disponueshëm atyre nga ofrues të tjerë të shërbimit publik telefonik.

h) Ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet të negociojnë ndërveprimin pas kërkesës së bërë nga një ofrues tjetër i shërbimit publik telefonik për të pasur akses në shërbimet reciproke të informacionit për numrat, brenda kuadrit të informacioneve që janë të hapura për publikun në shërbimet e tyre të informacionit për numrat.

i) Sipërmarrësit janë të detyruar të sigurojnë që aksesit i pajtimtarëve të një rrjeti të komunikimeve elektronike në shërbimet e kërimit të informacionit në Numeratorin Telefonik, që sigurohet me kod të shkurtër, nëpërmjet një rrjeti tjetër të komunikimeve elektronike ose në shërbimet e siguruara nga i njëjti rrjet i komunikimeve elektronike, në një zonë tjetër gjeografike, mund të realizohet nëpërmjet kodit të shkurtër, pa kërkuar formimin e një prefiksi të veçantë që i është caktuar rrjetit apo zonës gjeografike.

j) Ofruesit e shërbimit publik telefonik janë të detyruar të zbatojnë instruksionet e dhëna nga AKEP lidhur me çështjen e shërbimit të kërimit të informacionit në Numeratorin Telefonik.

k) Ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet të sigurojnë që ata vetë t'i përgjigjen çdo pyetje të bërë nga konsumatorët lidhur me çmimin e ngarkuar për thirrjet drejt shërbimit të kërimit të informacionit në Numeratorin Telefonik, me kode të shkurtër, që sigurohen nëpërmjet rrjeteve të tyre.

23.4 Shërbimet e postës zanore

Ofruesit e shërbimit publik telefonik janë të detyruar të sigurojnë akses për çdo përdorues fundor të lidhur nëpërmjet rrjetit të tyre publik telefonik në shërbimet e postës zanore.

23.5 Fatura e detajuar

a) Çdo faturë e dërguar Pajtimtarëve nga ofruesi, që tregon koston e shërbimeve telefonike të kryera, duhet të përfshijë një nivel minimal të fatures së detajuar, siç përcaktohet nga ligji. Faturat u dërgohen pajtimtarëve nga ofruesi i shërbimit, pa pasur nevojën e një pagese shtesë.

b) Përveç kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e telekomunikacioneve, AKEP ka të drejtë të përcaktojë nivelin e detajeve të faturës që i dërgohet pa pagesë konsumatorëve nga ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik në vendndodhje fikse, kështu që konsumatorët të jenë në gjendje:

- i. të verifikojnë dhe kontrollojnë shumat që i janë ngarkuar për përdorimin e rrjetit publik telefonik në vendndodhje fikse; dhe
- ii. të monitorojnë përdorimin e tyre dhe kostot përkatëse në mënyrë të përshtatshme, pra të kenë një nivel të arsyeshëm kontrolli mbi faturat e tyre.

c) Nëqoftëse është e nevojshme, ka mundësi t'i ofrohen pajtimtarëve fatura me më shumë elemente të faturës së detajuar përkundrejt një pagese të arsyeshme apo pa pagesë.

Çdo thirrje e bërë nga një pajtimtar pa pagesë, përfshirë thirrjet në linjat e ndihmës, nuk është e nevojshme të përfshihet në faturën e detajuar të pajtimtarit.

Detyrimi për dhënien e një niveli minimal të detajimit nuk zbatohet nëqoftëse pajtimtari ka deklaruar në mënyrë të shprehur se nuk dëshiron të marrë një faturë të tillë.

23.6 Tarifat

a) Pavarësisht nëse faturat për Shërbimet Publike Telefonike hartohen mbi bazën e sasisë së informacionit të transmetuar apo kohëzgjatjes së tij, faturat nuk duhet të mbulojnë periudha shërbimi më të gjata se një muaj.

b) Pajtimtarët nuk duhen faturuar për thirrje të papërfunduara për mos përgjigje të palës së thirrur, as dhe për kohen e harxhuar derisa pala e thirrur të përgjigjet. Nëqoftëse ka dyshime lidhur me faturat, pajtimtari ankohet me shkrim tek sipërmarrësi brenda 15 ditëve mbas marrjes së faturës. Po ashtu, pajtimtarët kanë të drejtë që, në perputhje me përcaktimet në kontratë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të ankohen në gjykatë.

c) Faturat duhet të tregojnë afatin e fundit për pagimin e tyre. Në çdo rast, një faturë nuk duhet të konsiderohet si e pa paguar në kohen e duhur deri 30 ditë nga data e nxjerrjes së saj, e cila është e shkruar në faturë. Sipërmarrësit duhet të marrin masa që faturat e nxjerra t'i dërgohen pajtimtarëve sa më shpejt që është e mundur.

23.7 Departamentet e shërbimit të konsumatorit

a) Çdo ofrues i shërbimeve publike telefonike duhet të sigurojë ekzistencën e procedurave për shqyrtimin e problemeve që hasen nga konsumatorët dhe duhet të ketë departamentet e

shërbimit të konsumatorit ose personel të trajnuar në mënyrë të duhur dhe speciale në pikat e tij të shitjes.

b) Në bashkëpunim edhe me AKEP, ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet të bëjnë një grupim të problemeve/pyetjeve që janë drejtuar tek departamenti i shërbimit të konsumatorit nga Përdoruesit dhe duhet të trajnojë personelin e shërbimit të konsumatorit që të jetë i aftë të trajtojë efektivisht, në mënyrë të standardizuar, të paktën çështjet e ndeshura me shpesh të përfshira në cilëndo kategori.

c) Ndër të tjera, ofruesit e shërbimit publik telefonik duhet t'i shërbejnë përdoruesit lidhur me çështjet e difekteve nëpërmjet një linje speciale pa pagesë e cila të punojë të paktën 12 orë në ditë, nga e Hëna deri të Shtunë.

23. 8 Transparenca dhe publikimi i informacionit

Sipërmarrësit e shërbimit publik telefonik janë të detyruar të publikojnë informacion të saktë, të qartë dhe të përditësuar lidhur me tarifat e tyre dhe kushtet për akses dhe përdorim të rrjetit të tyre publik telefonik nga Përdoruesit Fundorë.

a) Informacioni i publikuar duhet të përfshijë sa vijon:

- i. Emrin e sipërmarrësit dhe adresën e zyrave të tij qendrore.
- ii. Përshkrim të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun që ai ofron.
- iii. Procedurën që ndjek një Pajtimtar për paraqitjen e aplikimit për ofrimin e shërbimeve.
- iv. Në se ka tarifë të lidhjes dhe/ose pagesë periodike, përshkrim të shërbimeve që përfshihen (p.sh. shfrytëzim të shërbimeve të sipërmarrësit, numerator telefonik, shërbime të informacionit, faturim i detajuar, mirëmbajtje, etj.).
- v. Tarifat standarde që mbulojnë aksesin, gjithë tipet e pagesave të përdorimit dhe mirëmbajtjes, duke përfshirë detaje rreth uljeve të zakonshme ekzistuese dhe synimet speciale të skemave të tarifimit. Duhet përfshirë një përshkrim i mjaftueshëm i çmimeve individuale që zbatohen në çdo rast ndaj shërbimeve përkatëse për tip rrjeti, destinacion dhe zgjatje të çdo thirrje. Përveç kësaj, duhet të ketë një përshkrim të qartë të niveleve të tarifimit, në se ka të tillë. Nëqoftëse tarifat janë modifikuar në mënyrë të njëanshme, duhet të jepet një përshkrim i qartë i modifikimit të bërë, dhe Përdoruesve u duhet krijuar mundësia të kundërshtojnë këto modifikime dhe të përfundojnë kontratën pa asnjë kosto.
- vi. Politikën e kompensimit/ç'dëmtimit, duke përfshirë detaje të sistemit të kompensim/ç'dëmtimit.

vii. Tipet e shërbimeve të mirëmbajtjes që ofron, duke përfshirë afatin kohor të lidhjes së shërbimeve që ofron ose riparimin e difekteve.

viii. Cilësinë e shërbimeve të ofruara.

ix. Kushtet standarde kontraktuale, duke përfshirë, në se është e nevojshme, zgjatjen minimale të kontratës.

x. Mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe rregullimin e llogarive.

b) Informacioni i mësipërm duhet publikuar si vijon:

- i. Duke i dërguar informacionin e mësipërm, dhe në mënyrë të veçantë çdo tekst të kontratës së zbatueshme apo pjesë të saj, çdo Përdoruesi Fundor që paraqet një kërkesë.
- ii. Duke vendosur informacionin e mësipërm në faqen elektronike të sipërmarrësit, ose nëqoftese kjo faqe nuk ekziston, duke e bërë materialin e mësipërm të disponueshëm për çdo palë të interesuar pa pagesë në zyrat qendrore të sipërmarrësit.
- iii. Në mënyrë më specifike, çdo sipërmarrës është i detyruar të japë gjithë informacionin që lidhet me tarifat në çdo pikë shitjesh të shërbimeve ose të verë në funksionim një qendër telefonike që jep informacion mbi tarifat.

Detyrimet e mësipërme nuk zbatohen ndaj shërbimeve telefonike që ofrohen nëpërmjet telefonave publikë.

24. Portabiliteti i numrave

Çdo sipërmarrës që ofron rrjete dhe shërbime publike telefonike është i detyruar të sigurojë portabilitetin e numrave në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9918, Rregullores Nr. 13 datë 16. 04. 2010 “Për portabilitetin e numrit” dhe vendimeve të AKEP-it për këtë qëllim.

25. Numrat jo gjeografikë

Nëqoftese një sipërmarrësi të shërbimit publik telefonik i janë caktuar numra jogjeografikë nga Plani kombëtar i Numeracionit, ky i fundit duhet të sigurojë, kur është teknikisht dhe financiarisht e mundur, që të gjithë përdoruesit fundorë të kenë akses në këto numra.

26. Detyrime Shtesë lidhur me Ofrimin e Shërbimeve Publike Telefonike fikse

Dispozitat e mëposhtme kanë të bëjnë me detyrime shtesë që ju vendosen sipërmarrësve që ofrojnë shërbime publike telefonike fikse. Kështu, çdo sipërmarrës që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe ofron Shërbime Publike Telefonike fikse është i detyruar të zbatojë keto dispozita.

26. 1 Ofrimin e Telefonisë fikse nga ofruesit virtualë

- a) Ofrues virtual (OV) është një sipërmarrës që, megjithëse nuk ka infrastrukturën e tij të komunikimeve elektronike, ofron shërbime të komunikimeve elektronike nën emrin e tij tregtar bazuar në infrastrukturën e sipërmarrësve të tjerë që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime të bazuara në kontratat respektive me ta.
- b) Në rastin e Ofruesve Virtualë të Shërbimeve Publike Telefonike fikse, në mënyrë që të sigurohet ofrim i vazhdueshëm i shërbimeve, ata duhet të kenë arritur të paktën dy kontrata bashkëpunimi me sipërmarrësit që ofrojnë Shërbime Publike Telefonike fikse nëpërmjet Rrjeteve të këtyre sipërmarrësve.

27. Detyrime lidhur me vendosjen e telefonave publikë

Dispozitat e mëposhtme i përkasin detyrimeve shtesë që u vendosen sipërmarrësve që ofrojnë telefona publikë. Kështu, çdo sipërmarrës që vepron nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe vendos telefona publikë është i detyruar të zbatojë dispozitat e mëposhtme.

Për qëllim të këtij paragrafi, telefonat publikë janë ata që janë instaluar në mënyrë të përhershme në vende publike ku aksesimi është i mundur 24 orë.

Çdo sipërmarrës që ofron telefona publikë duhet të sigurojë mundësinë e thirrjes së numrave të emergjencës pa pagesë.

Sipërmarrësi është përgjegjës për instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e këtyre telefonave. Sipërmarrësi që ofron telefona publikë duhet të sigurojë shërbime telefonike dhe, në mënyrë të veçantë, shërbimet vijuese:

- a) Akses në numrat telefonikë në mënyrë të tillë që gjithë shërbimet e informacionit që ofrohen nëpërmjet serive 118XX të mundësohen nga të gjithë telefonat publikë, nëse një gjë e tillë është teknikisht e mundur.
- b) Akses pa pagesë në shërbimet e emergjencës pa përdorim karte apo monedhe.
- c) Akses në shërbimet e postës zanore.

Sipërmarrësit janë të detyruar të tregojnë informacionin vijues, në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe lehtësisht të dallueshme, në zonën ku janë instaluar telefonat:

- d) Informacion mbi pagesat e bëra dhe mënyrat e e pagimit për shërbimet në fjalë. Duhet të ketë një informim të mjaftueshëm dhe të qartë për çmimet individuale që zbatohen për destinacionin dhe kohën kur është bërë thirrja. Përveç kësaj, duhet të ketë informim të qartë mbi nivelin e tarifimit dhe tarifën minimale.
- e) Duhet të tregohet mundësia e kryerjes së thirrjeve të emergjencës.
- f) Duhet të tregohet mundësia e marrjes të thirrjeve hyrëse.
- g) Numri i kontaktit nëse ka ankesa ose probleme.

Sipërmarrësi që ofron telefona publikë duhet të sigurojë që 75% e telefonave publikë të jenë të aksesueshëm nga personat që përdorin karrike me rrota.

Sipërmarrësi që ofron telefona publikë duhet të konsultohet me AKEP mbi specifikimet e telefonave publikë që ai ka ndërmend të instalojë, në mënyrë që të sigurojë që çështjet lidhur me personat me aftësi të kufizuara të merren në konsideratë në instalimin dhe ofrimin e telefonave publikë.

28. Detyrime lidhur me ofrimin e shërbimeve të informacionit multimedialë

Dispozitat e mëposhtme i takojnë detyrimeve shtesë që u vendosen sipërmarrësve që ofrojnë Shërbime të Informimit Multimedialë. Ky shërbim përfshin Audiotekstin dhe Videotekstin, mesazhet e shkurtër me vlerë të shtuar (SMS) dhe mesazhet multimedialë me vlerë të shtuar (MMS). Kështu, çdo sipërmarrës që punon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm dhe ofron shërbime informimi multimedialë është i detyruar të zbatojë dispozitat e mëposhtme:

T'ju japë përdoruesve informacion të mjaftueshëm mbi tarifat për shërbimet e informacionit multimedial. Përpara ofrimit të shërbimit, në fillimin e thirrjes, ata janë të detyruar të sigurojnë, nëpërmjet një mesazhi të regjistruar, pa pagesë për përdoruesit, një përshkrim të qartë të tarifave të aplikueshme dhe, në varësi të rastit, nëse shuma totale paguhet pavarësisht nga kohëzgjatja e thirrjes, apo shuma që paguhet llogaritet me njësi kohore si dhe pagesën rezultuese për minutë, duke përfshirë Taksën e Vlerës së Shtuar (TVSH). Në mënyrë më specifike, lidhur me mesazhet e shkurtër me vlerë të shtuar (SMS) dhe mesazhet multimedialë me vlerë të shtuar (MMS), ofruesit janë të detyruar të informojnë çdo përdorues menjëherë mbas transmetimit të mesazhit të parë, rreth tarifave për mesazh, numrin total të mesazheve që kërkohen për ofrimin e shërbimit, kur është e mundur, dhe koston maksimale totale të shërbimit për përdorues, duke përfshirë TVSH korresponduese.

Të mos tarifojë konsumatorët për kohën që ata humbasin duke pritur të lidhen me shërbimin ose, në se është teknikisht e mundur, të mos i përgjigjet një thirrjeje të konsumatorit kur nuk ka linjë të disponueshme për ofrimin e shërbimit.

Të mos lejojë thirrje më të gjata se 15 minuta.

Gjatë reklamimit promovues të shërbimeve, tarifat duhet të përshkruhen qartë në përputhje me dispozitën e mësipërme për mesazhin e regjistruar, ata duhen shkruar qartë dhe horizontalisht, dhe duhen treguar në çdo sipërfaqe promociionale në rastet e reklamave të shtypura, apo multimediale, ose ata duhen prezantuar qartë, në varësi të rastit për minutë, për thirrje ose për mesazh, së bashku me numrin maksimal të mesazheve që kërkohen për ofrimin e shërbimit, kur përdoret promovim zanor nëpërmjet një mediumi elektronik apo mediumi tjetër. Në rastin e reklamave multimediale tarifat duhen shkruar në përputhje me kërkesat e mësipërme gjatë gjithë kohëzgjatjes së një reklame në pozicion fiks dhe jo në shirit të lëvizshëm.

Të vendosë në funksionim një linjë ankesash, pa asnjë pagesë shtesë, e cila ka të bëjë me njoftimet – reklamat të lidhura me shërbimin në fjalë.

29. Detyrime lidhur me ofrimin e kartave të parapaguara

a) Ofruesit e kartave të parapaguara janë të detyruar të sigurojnë, së bashku me kartat, një fletë informacionesh që përmban gjithë informacionin për tarifat, siç përshkruhet në

paragrafin vijues ose të vënë në funksionim një qendër telefonike, që siguron pa pagesë, informacion të detajuar mbi tarifat.

b) Informacioni që duhet siguruar për tarifat duhet të tregojë mjaftueshëm dhe qartë, informacionin e mëposhtëm:

- çmimet individuale që zbatohen në çdo rast ndaj shërbimeve përkatëse sipas tipit të rrjetit;
- nivelin e tarifimit, pagesën minimale ose pagesën për përgjigjen ndaj thirrjes, në se ka të tillë;
- uljet që zbatohen zakonisht;
- datën e përfundimit të vlefshmërisë të kartës.

30. Rrezatimi Elektromagnetik

Sipërmarrësi i autorizuar do të pajtohet me çdo standard të emetimit të rrezatimit të miratuar dhe të publikuar në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi.

31. Siguria e rrjeteve publike

Sipërmarrësi i autorizuar duhet të marre të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kundër të aksesit së paautorizuar mbështetur në Direktivën 2002/58/EC amenduar me Direktivën 2009/136/EC, Direktivën 2006/24/EC të Këshillit dhe Parlamentit Europian dhe në zbatim të nenit 121, 122,123 e më tej të ligjit 9918.

32. Pagesat

Sipërmarrësi i Autorizuar është i detyruar të paguajë të gjithë detyrimet financiare sipas përcaktimeve në ligjin 9918, ligjin për taksat dhe VKM nr.599, datë 23.7.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”.

Pagesat që kryhen në AKEP janë:

1. Pagesa për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.

Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit, janë të detyruar të paguajnë një pagesë vjetore për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga AKEP-i. Kjo pagesë nuk duhet të jetë më shumë se 0,5 % e së ardhurës vjetore të vitit kalendarik të mëparshëm dhe duhet të realizohet brenda datës 30 prill të çdo viti.

2. Pagesa për caktimin dhe përdorimin e frekuencave.

3. Pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike.

4. Pagesa për financimin e shërbimit universal.

Për kompensimin e kostove të shërbimit universal krijohet fondi i këtij shërbimi i cili menaxhohet dhe administrohet nga AKEP. Ky fond krijohet nga sipërmarrësit që zotërojnë rrjete të komunikimeve elektronike publike dhe ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike publike dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve

elektronike publike në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me rregulloren e AKEP-it.

5. **Pagesa për tarifën e shërbimit të radiokomunikacionit.**

Në bazë të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe AKEP, Nr. 28, datë 06.10.2008, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit” i ndryshuar, AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit

Komentet e operatorëve dhe qëndrimi i AKEP, pas Këshillimit Publik të Projekt-Rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm:

1. Komentet dhe qëndrimi i AKEP mbi rregulloren për Autorizimin e Përgjithshëm:

- Komenti 1. Neni 1 par.2: Lutemi të specifikoni konkretisht me referenca të sakta rregulloret e BE dhe ato Ndërkombëtare të Radiokomunikimit në fuqi në të cilat referohen termat e përdorura në këtë Rregullore.
- Komenti 2. Kreu II-Neni 3 par.3 është i paplotë dhe nuk perfundon mendimi. Lutemi të shkruhet paragrafi i plotë.
- Komenti 3. Neni 5 par.4. tek rreshti i dyte: Rregullorja hierarkisht duhet të citohet pas ligjit. Gjithashtu, sygjerohet të specifikohen saktë së për cilat rregullime ligjore dhe nënligjore në fuqi bëhet fjalë.
- Komenti 4. Neni 6 par.3 : sygjerohet të referohen specifikisht rastet kur AKEP ka të drejtë të bëjë këtë (pra modifikimin apo fshirjen e të dhënave)
- Komenti 5. Neni 7 par.2: në cilat ligje të tjera përveç ligjit 9918 ekziston një detyrim për të dhënë informacion pranë AKEP?
- Komenti 6. Neni 9 par.1: rrjeshti 4: jemi dakort për sa bëhet fjalë në lidhje me likuidimin ndërkohë, falimentimi është një proces ku shoqëria nuk është iniciuese. Duhet të përcaktohet qartë se mbi cilin person rëndon detyrimi për të informuar AKEP.
- Komenti 7. Neni 10 par.2: kërkohet një referim specifik dhe konkret në dispozitat e ligjit në fjalë.
- Komenti 8. Bazuar në nenin 1, pika 3 e Rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm, sugjerohet që përgjatë dokumentit në vend të person/subjekt të përdoret vetëm person/at.
- Komenti 9. Në nenin 3 pika 3, të rregullores së AP paragrafi është i paplotë. Ju lutem mundësoni plotësimin e tij për efekt konsultimi.
- Komenti 10. Në nenin 4, pika 1 (Çertifikata Standarte e lëshuar nga AKEP) të rregullores paragrafi është i paplotë. Ju lutem mundësoni plotësimin e tij për efekt konsultimi.
- Komenti 11. Në nenin 13, pika 2, kërkohet një përcaktim më i saktë i personave që përfshihen në grupin e referuar në rreshtin e katërt të paragrafit në vijim të shkronjës b) e pikërisht “rishitësit e tyre”
- Komenti 12. Në bazë të Nenit 4 të projekt-rregullores AKEP lëshon një certifikatë që vërteton se aplikuesi ka bërë një njoftim të rregullt mbi shërbimet dhe do të ofrojë rrjete dhe shërbime sipas parashikimeve në formën e aplikimit. Konsiderojmë që një mangësi e theksuar e regjimit aktual po rikonfirmohet edhe në Projekt Rregulloren e propozuar nga AKEP . Jemi të mendimit që AKEP nuk duhet të mjaftohet vetem me verifikimin nëse aplikuesi ka shënuar rutinë përkatëse të duhur në formularin e njoftimit, por duhet të bëjë minimalisht edhe një vërtetim për ekzistencën e këtij rrjeti. Nga pikëpamja rregullatore, në momentin që aplikuesi ka marrë një certifikatë nga AKEP ai mund të quhet operator i autorizuar dhe të pretendojë të gjitha të drejtat që i përkasin një operatori në bazë të kuadrit rregullator e ligjor në fuqi. Në fakt praktika ka treguar se shumë operatorë, edhe pse kanë deklaruar se operojnë rrjete të komunikimeve elektronike nuk kanë asnjë rrjet të tillë në përdorim. Me miratimin edhe të Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit (VKD Nr.

1300, datë 14.06.2010) është saktësuar koncepti i rrjetit publik të telefonisë. Kjo rrit nevojën e verifikimit nëse operatorët e autorizuar sipas regjimit aktual (VKD Nr. 495, datë 19.09.2008) realisht janë operatorë që përdorin rrjet publik të telefonisë.

Për këtë arsye, insistojmë që funksioni i AKEP në momentin e lëshimit të Çertifikatës nuk duhet të jetë thjesht administrative (protokollues), por duhet të ndërmarrë edhe një ekzaminim fizik/teknik të asaj që pretendohet në formularin e aplikimit.

Për këtë arsye, mbështesim adoptimin e variantit të dytë të formularëve të njoftimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, bashkëngjitur projekt rregullore për autorizimin e përgjithshëm. Në këtë variant kërkohet të saktësohet koha kur do të vihet në punë rrjeti publik i telefonisë, kërkohet një përshkrim më i detajuar i teknologjisë që do të përdoret për ndërtimin e rrjetit etj.

AKEP duhet të verifikojë aktivisht deklaratat e operatoreve ekzistues në treg, Kjo duhet të parashikohet shprehimisht edhe në Projekt Rregullore.

Komenti 13. Në Nenin 11, pika 1, Projekt Rregullorja përcakton se subjektet që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm duhet të shlyejnë detyrimet e tyre tek AKEP në lidhje me mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike Ndërkohë konstatojmë se aktualisht , kjo pagese nuk mblidhet, edhe pse ajo duhet të jete baza kryesore mbi të cilat ndërtohet buxheti i AKEP. Tashmë është miratuar edhe Rregullorja për Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike (VKD Nr.1170, datë 19.02.2010). Fatkeqsisht edhe pse ekziston baza ligjore dhe rregullatore, ende asnjë operatorë i autorizuar nuk paguan këtë pagese tek AKEP. Buxheti i AKEP sot financohet në masen 96% nga të ardhurat prej pagesave për frekuencat. Duke qenë se edhe Projekt Rregullorja përcakton qartazi detyrimin e një operatori të autorizuar për të shlyer këtë lloj pagese, duhet patjetër të saktësohet në tekstin e projekt rregullores se mos pagimi i kësaj pagese brenda maksimalisht 12 muajsh nga moment i lëshimit të Çertifikates nga AKEP do të sjellë shfuqizimin automatik të saj.

Qëndrimi i AKEP për komentet e mësipërme:

AKEP duke vlerësuar komentet e operatorëve ka marrë në konsideratë dhe ka kryer pasqyrimin e tyre në paragrafet respektive sipas komenteve 2, 9 dhe 10.

Në lidhje me specifikimin e akteve të ndryshme ligjore, nënligjore, akteve rregullatore si dhe rregulloreve të ndryshme ndërkombëtare në fuqi, AKEP vlerëson dhe informon palët e interesuara se legjislacioni dhe aktet rregullatore gjenden të publikuara në faqen zyrtare të AKEP, www.akep.al.

AKEP vlerëson se, nëse një subjekt është në falimentim ose në likuidim, AKEP duhet të njoftohet nga ky subjekt brenda 7 ditësh nga shpallja e vendimit të gjykatës apo vendimit të asamblesë së përgjithshme të ortakëve, sipas rastit.

AKEP vlerëson se kushdo që ofron shërbime të komunikimeve elektronike me emër të ndryshëm tregtar dhe shoqëritë e ndara duhet të plotësojnë Njoftimin e Regjistrimit në

përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, jo më vonë se 2 muaj nga publikimi i akteve rregullatore të miratuara rregullisht dhe në vijimësi.

AKEP në zbatim të rregullimeve të kreut XVI, të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 me strukturat përkatëse kryen inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga regjimi i autorizimeve për sipërmarrësit.

Gjithashtu në projekt-rregulloren e sipërcituar janë hequr përcaktimet e nenit “Dispozita tranzitore” duke i pasqyruar ato në Vendimin e KD duke vendosur një afat 3 muaj nga miratimi i vendimit për paraqitjen e Njoftimit të Regjistrimit nga sipërmarrësit aktualë të regjistruar ndërsa për sipërmarrësit e rinj rregullorja e re e Autorizimit të Përgjithshëm do të aplikohet menjëherë.

2. Komente mbi Aneks A-(Varianti parë), i rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm:

- Komenti 1. *Pika I, propozojmë zëvendësimin e Forma ligjore e “kompanisë” me Forma ligjore e “shoqërisë” në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.*
- Komenti 2. *Tabela shoqëruese e pikës I, propozojmë zëvendësimin e shoqëri “anonime” me “aksionere” në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.*
- Komenti 3. *Pika II, propozojmë zëvendësimin e të dhënave të kompanisë me të dhënat e “shoqërisë” në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.*
- Komenti 4. *Tabela shoqëruese e pikës II.a ju lutem të saktësohet kuptimi i emri i “kronuar” dhe zëvendësimi i emri i “veçantë” me Emri i “Markës Tregtare të Shoqërisë (nëse ka)”.*
- Komenti 5. *Në pikat V, VI, VII të Aneksit A (varianti i parë) propozojmë zëvendësimin e fjalës “kompanisë” me “shoqërise” në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.*
- Komenti 6. *Në paragrafin që fillon me shprehjen “Paraqitja e Detyrimeve Ligjore”, propozojmë zëvendësimin e fjalës “kësaj” me “këtij dokumenti” në të gjithë 5 deklaratimet.*
- Komenti 7. *Në fundin e faqes të Aneksit A (varianti parë) ku është përcaktuar Emri/Firma/Vula e Kompanisë, propozojmë zëvendësimin e fjalës “Kompanisë” me “shoqërise” në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.*

Qëndrimi i AKEP për komentet e mësipërme:

AKEP duke parë që varianti 2 i Aneksit A është më i detajuar për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, ka vendosur që varianti 2 të jetë pjesë e Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm. Në Aneksin A (varianti 2) është përdorur emërtimi “Personi”

njëlloj siç përcaktohet në nenin 1, pika 3 të projekt-rregullores. Gjithashtu AKEP ka bërë pasqyrimet përkatëse në dokumentet rregullatorë në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

3. Komente mbi Aneks A-(Varianti i dytë), i rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm

- Komenti 1. Pika 2, Seksioni A (Rrjete Publike të Komunikimeve Elektronike) faqe 4, propozojmë se duhet të sqarohen përkufizimet e koncepteve: Radio support, Optical Support sipas pikës 2.1.2 (Rrjeti i Transmetimit) dhe të konceptit Vendodhja e pajisjeve sipas pikës 2.2.3 (Rrjeti i Transmetimit).
- Komenti 2. Pika 1, Seksioni C (Shërbime Publike të Komunikimeve Elektronike), faqe 12, propozojmë shtimin e shprehjes “të hapura (komutuar)” në vijim të përcaktimit të pikës 1.4.3 (Teknologjitë e transportimit): “Qarqe të mbyllur” që në përfundim lexon: Qarqe të mbyllur/të hapur (komutuar).
- Komenti 3. Pika 3, Seksioni C (Shërbime Publike të Komunikimeve Elektronike), faqe 13, propozojmë shtimin e dy kutive me emërtimet përkatëse:
- ☐ Të tjera, dhe
 - ☐ MPLS-TP në pikën 3.1.3 (shërbimet e transmetimit të të dhënave)
- Komenti 4. Në paragrafin që fillon me shprehjen “Paraqitja e Detyrimeve Ligjore”, propozojmë zëvendësimin e fjalës “kësaj” me “këtij dokumenti” në të gjithë 5 deklaratimet.

Qëndrimi i AKEP për komentet e mësipërme:

AKEP në përfundim të këtij procesi ka vendosur dhe ka saktësuar variantin përfundimtar të Njoftimit të Regjistrimit (Aneksi A) për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Në këtë formular janë vendosur kërkesa edhe për paraqitjen e:

- të dhëna për sistemin e billingut;
- kontratën tip të pajtimit (termat dhe kushtet e përgjithshme);
- formulari i aplikimit për caktimin e Kodit NSPC (sipas kërkesave të pikës C1 të formularit);
- formulari i aplikimit për caktimin e Kodit ISPC (sipas kërkesave të pikës C1 të formularit);

Për të pasur një informacion më të plotë nga ana teknike, janë kërkuar edhe disa të dhëna të tjera teknike shtesë si psh: tipi i sinjalizimit, të dhënat e pikës së sinjalizimit, kodi i pikës së sinjalizimit të operatorit në distancë, etj.

4. Komente mbi Aneks C-Kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm, i rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm

- Komenti 1. Pika 1: “Kapitulli” sugjerojmë të zëvendësohet me “Aneksi”
- Komenti 2. Pika 1.1.1 rrjeshti 5: të specifikohet saktë numri dhe data e ligjit
- Komenti 3. Pika 1.1.2, paragrafi c), faqja 1, Caktimi i numeracionit nga Plani Kombëtar i Numeracionit, sugjerohet rishikimi i të gjithë paragrafit duke pasur parasysh sa më poshtë:
- i) ka paqartësi lidhur me cilësinë e pronarit si dhe të drejtën e sipërmarrësit për të kaluar pronësinë e numrit të pajtimtarit
 - ii) në rreshtin e tretë, të paragrafit të dytë të pikes 1.1.2 c) pas b) parashikohet e drejta e AKEP për të hequr të drejtën e përdorimit të numrave automatikisht me kalimin e një afati 3 vjeçar në rast se numrat nuk përdoren nga sipërmarrësi. Duke patur parasysh përballimin e kostove financiare për numrat apo serive numerike që alokohen nga AKEP, jemi të mendimit që të adoptohet njëra prej versioneve të mëposhtme:
 - a) ndryshohet ky paragraf duke parashikuar që e drejta për përdorimin e numrave të vazhdojë për të gjithë kohëzgjatjen e Autorizimit Individual përkakatës ose,
 - b) ndryshohet ky paragraf duke shtuar në fund të rreshtit të tretë të këtij paragrafi pas fjalës “AKEP” shprehjen “..., përveç rastit kur sipërmarrësi ka përdorur qoftë edhe njërin prej numrave të një blloku/serie numerike prej dhjetëmijë numrash”>
- Komenti 4. Pika 1.1.3 par. a) pika I; jemi të mendimit se kjo është e qartë dhe pa pasur nevojë të shprehet këtu në këtë paragraf.
- Komenti 5. Në pikën 1.1.3, paragrafi b), faqja 2, propozojmë që AKEP mund të heqë të drejtën për përdorimin e radiofrekuencave nga sipërmarrësi vetëm pas përfundimit të afatit të kohëzgjatjes të Autorizimit Individual përkatës.
- Komenti 6. Pika 1.2 par. b) rrjeshti i parafundit: fjala “mund” duhet të zëvendësohet me “do të”
- Komenti 7. Ne piken 1.2, paragrafi a), faqja 2, konstatojmë se masa e sigurimit të cfarëdo dokumentacioni/informacioni, kontratë, etj.... AKEP-itë e papercaktuar qartë. Propozojmë që të specifikohet me tej lloji i dokumentave/informacionit që do të kërkohej për këtë qëllim.
- Komenti 8. Pika 1.2.1 par. b) pika iii: jemi të mendimit që kjo pikë duhet riformuluar në mënyrë për të nxjerrë kuptimin e vërtetë të kësaj kërkesë.
- Komenti 9. Pika 1.3.1 par. c) kërkojmë një referim specifik të sanksioneve në fjale.
- Komenti 10. Pika 1.3.1, në përfundim të paragrafit b), faqja 3, propozojmë shtimin e një paragrafi të ri të formuluar sipas variantit të mëposhtëm:
 “Sipërmarrësi që konstaton interference të dëmshme në rrjetin e tij, të shkaktuara nga cdo sipërmarrës tjetër të vendeve fqinje të cilët përdorin radiofrekuencë, do të njoftojë menjëherë AKEP nga konstatimi. AKEP do të ndërmjetësojë për të zgjidhur rastet e mosmarreveshjeve midis sipërmarrësve vendas dhe atyre të vendeve fqinje kur konstatohen interference të dëmshme ndërkufitare”.
- Komenti 11. Pika 2.1.1 par. a) pika i: në lidhje me fjalinë e fundit të kësaj pikë lind pyetja: Përse ky detyrim specifik për telefoninë fikse?
- Komenti 12. Pika vi: “qytetit” sugjerojmë të zëvendësohet me “njësisë vendore”.

- Komenti 13. Pika 2.1.2 par. a) kërkojme të vihet referimi i saktë i numrit dhe datës së ligjit në fjalë.
- Komenti 14. Pika 2.1.3: ky paragraf mendojmë se është një dispozitë parazitare për arsye se ky detyrim ekziston dhe poshtë kësaj rregullore.
- Komenti 15. Pika 2.1.4 par.a): sygjerojmë që togfjalëshi “dëmtimit të planit rregullues të qytetit” të zëvendësohet me “kërkesave të legjislacionit për planifikimin e territorit”.
- Komenti 16. Pika 2.1.5 par a) pika v: kërkojmë një referim specifik të dispozitave në fjalë.
- Komenti 17. Në pikën 2.1.5, paragrafi a) faqja 6, në rreshtin e katërt të nënparagrafit I, sugjerojmë zëvendësimin e “aplikimit” me “kërkesë” në përputhje me ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
- Komenti 18. Pika vi: mendojmë që ky paragraf ka një formulim të paqartë. Kërkojmë të saktësohet kuptimi i “sjelljes se papëlqyeshme”.
- Komenti 19. Pika 2.1.9 par. a) të specifikohen rregullat e AKEP.
Par.b) në lidhje me “informacion krahasues” kërkojmë të na bëhet e qartë se çfarë është ky informacion krahasues pasi ky nuk është term i përkufizuar.
- Komenti 20. Pika 2.1.11 par. c) kërkojmë një referim të saktë të dispozitave ligjore në fuqi.
- Komenti 21. Pika 2.1.12- mbrojtja e konsumatorit: sygjerojmë që nuk duhet të ketë përsëritje të detyrimeve ligjore të cilat burojnë nga ligjet në fuqi.
Par. a): ky paragraf mendojmë se është një dispozitë parazitare
“E pavlerë” Pyetje: cdo të thotë e pavlerë në këtë rast?
- Komenti 22. Pika 2.1.13 par a) fjalia e fundit: mendojmë se kjo fjali reflekton vendimin përkatës të AKEP në lidhje me miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së abonentit
Par. b) Mendojmë se ky paragraf është një dispozitë parazitare.
Par. g) në lidhje me këtë paragraf lind pyetja: a është ky dokumenti ku duhet saktësuar një ndalim i tillë?
- Komenti 23. Në pikën 2.1.13, paragrafi e), nënparagrafi vii, faqja 11, propozojmë që gjykata kompetente në rastin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të jetë ajo e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Komenti 24. Pika 2.1.14 par b) ju bëjmë me dije se Kodi Civil nuk e njeh konceptin Demin indirekt. Gjithashtu na lind pyetja: çfarë nënkuptohet me dëm moral?
Par. d) Mendojmë që kjo dispozitë i ezauron të gjitha dispozitat e tjera.
- Komenti 25. Pika 2.1.16 par. a) jemi të mendimit se Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk është i vetmi organ me kompetence në fushën e sigurisë kombëtare.
Par.b) sygjerojmë të definohet termi Autoritetet kompetente. Në lidhje me gjendjen e jashtëzakonshme apo emergjencën civile të referohet ligji përkatës.
- Komenti 26. Pika 3.1.2 në lidhje me shërbimet e kërimit të informacionit në Numeratorin Telefonik lind pyetja: A është e mundur kjo për operatorët mobile?
- Komenti 27. Pika 3.1.2 par.b) në lidhje me këtë paragraf lind pyetja: A është e mundur praktikisht zbatimi i këtij paragrafi? A mund të riformulohet ky paragraf si zgjedhje e pajtimtarit?
- Komenti 28. Pika 3.1.3, faqja 15 (Shërbimet e postës zanore). Paraqitet e nevojshme për t’u qartësuar nëse ofrimi i këtij shërbimi është i detyrueshëm apo jo për sipërmarrësit e telefonisë së lëvizshme. Nëse është i detyrueshëm është i

nevojshëm informacioni nga AKEP në lidhje me afatin për zbatim si dhe nxjerrjen Live të këtij shërbimi.

Mendojmë se ky shërbim nuk duhet të jetë i detyrueshëm për zbatim pasi:

- Në përgjithësi ky shërbim konsiderohet i vjetër tashmë dhe me penetrim shumë të ulët në treg
- Përqindja e personave të cilët kanë një adresë poste zanore në sistem nuk i kalon 4-5% të bazës aktive të pajtimtareve, çka do të thote një nivel akoma më i ulët për bazën reale të operatoreve, ndërkohë që aktiviteti i postës zanore rezulton të jetë akoma dhe më i ulët
- Penetrimi i shërbimit në vendet e tjera të Europës dhe BE ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë i ulët megjithë tentativat e operatoreve për ta rivitalizuar me oferta ose promocione.
- Konsiderohet si një barriere kulturore që nuk lejon zhvillimin e shërbimit në të gjitha vendet europiane. I vetmi rajon ku shërbimi është edhe aktualisht i suksesshëm është Amerika Veriore si pasojë e induktimit të shërbimit nga telefonia fikse.
- Shërbimi mund të jetë i vlefshëm vetëm për telefoninë fikse.
- Nga ana komerciale nuk ofron asnjë shërbim shtesë për pajtimtarin dhe është i suprimuar tashmë nga shërbimi i Missed Call Notification.
- Është një mjet komunikimi i cunguar sepse pajtimtarët nuk i dëgjojnë mesazhet që marrin në sekretarinë telefonike, pajtimtarët kanë tendencën të përfundojnë telefonatën në momentin që nuk ka interaktivitet njëzëz në anën tjetër të linjes.

Komenti 29. Pika 3.1.4 në fjalinë: kur bëhet e ditur se “nëse periudha 45 ditore nga njoftimi i kontratës kalon pa marrë ndonjë përgjigje” të specifikohet: pa marrë përgjigje nga AKEP.

Komenti 30. Në pikën 3.1.4, faqja 15, propozojmë që afati kohor për paraqitjen në AKEP të çdo kontrate, të shkurtohet nga “2 muaj” në “1 muaj”. Gjithashtu propozojmë që edhe afati i vlerësimit nga ana e AKEP të kontratave të shkurtohet nga “45 ditë” në “15 ditë”.

Komenti 31. Pika 3.1.5 par. b) ju bëjmë me dije se nuk ka asnjë dispozitë ligjore që e ndalon komunikimin me SMS, i cili vlen të theksohet se është një komunikim me shkrim por i dërguar elektronikisht me SMS.

Par. c) a nuk janë afatet disi të stergjatura, gjë që mund të japi mundësi pajtimtarit të thellojë detyrimet ndaj operatorit duke u bërë kështu rrezik për shoqërinë nëpërmjet paaftësisë së tij paguese.

Komenti 32. Pika 3.1.6 par. a) në këtë paragraf duhet të theksojmë se këto që janë shkruar janë kërkesa të ligjit dhe nuk ka nevojë të përfshihen këtu në këtë dispozitë.

Komenti 33. Pika 3.1.7 par.a) ju bëjmë me dije se kërkesat e ligjit për TVSH-ne janë për faturim mujor.

Par. b) fjalja e parë: Kjo nuk buron nga ligji. AKEP nuk mund të percaktojë në këte rregullore ndalimin e këtij lloji.

Komenti 34. Pika 3.1.8 par.c) në lidhje me këte paragraf jemi të mendimit që ky detyrim paraqet një kosto shtesë për operatorin. A është e mundur që ky detyrim të burojë nga një akt i tillë nënligjor?

Komenti 35. Pika 3.2.1 par.b) lind pyetja : A është e drejtë kjo?

Komenti 36. Pika 3.5 par.iii) nuk jemi dakort me këtë dispozitë. Cfarë ndodh me abonentët të cilët dëshirojnë të flasin me gjatë se 20 min? Gjithashtu këto 20 min janë në

ditë? Në javë? Në muaj? Apo bëhet fjalë për çdo thirrje me kohëzgjatje prej 20 min?

Komenti 37. Në pikën 3.5, paragrafi iii, sugjerojmë që kohezgjatja e përcaktuar si “ jo më shumë se 20 minuta” të fillojë të llogaritet nga momenti kur fillon tarifimi e në këtë rast paragrafi do të lexojë “.....iii) “jo më e gjatë se 20 minuta nga momenti i tarifimit”.

Komenti 38. Në pikën 3.5 është bërë një element shtesë persa i përket ofrimit të shërbimeve me vlerë të shtuar me SMS ose MMS. Rregullorja për Numeracionin (VKD Nr.932 datë 11.08.2009) ka përcaktuar një sërë masash rregullatore për mbrojtjen e përdoruesve. Në Aneksin C të projekt Rregullores përmendet edhe një element shtesë që nuk gjendet në rregulloren e Numeracionit. Sipas pikës 3.5, ofruesi i shërbimit me vlerë të shtuar (SMS apo MMS) duhet të njoftojë numrin total të mesazheve që kërkohen për ofrimin e shërbimit si dhe koston maksimale totale të shërbimit për përdorues. Sikurse edhe mund të merret me mend, ky lloj informacioni është tërësisht i pamundur të jepet në shumicën e rasteve të ofrimit të shërbimeve me vlerë të shtuar. Konsiderojmë se njoftimi i koston se sms në fillim të shërbimit është një masë e mjaftueshme për të informuar përdoruesin, dhe nuk ka asnjë dobi në këtë detyrim shtesë që nuk gjendet as në Rregulloren e Numeracionit. Për këtë arsye kërkojmë që propozimi i sipërpërmendur të hiqet.

pika 3.5.iii e Aneksit C të Projekt Rregullores përcakton kohëzgjatjen prej 20 minutash për një thirrje tek një numër me vlerë të shtuar, ndërkohë që Rregullorja e Numeracionit përcakton kohëzgjatjen maksimale deri në 15 minuta. Mendojme se duhet të arrihet në një unifikim të standarteve në këtë rast.

Në pikën 3.5.v, përcaktohet detyre e cdo ofruesi të shërbimit me vlerë të shtuar që të vere në dispozicion një linjë ankesash pa asnjë pagesë shtesë. Konsiderojmë se kjo është një masë e tepërt, sidomos duke patur parasysh se ky segment tregu nuk është ende shumë i zhvilluar në Shqipëri.

Komenti 39. pika 3.6.a, përcaktohen detyrimet e një operatori për thirrje me karta të parapaguara, sidomos në lidhje me informacionin me tarifën që zbaton këta operatorë. Në këtë pikë përcaktohet se ky informacion mund të përgatitet si fletëpalosje dhe të vendoset nëpër pika shitjeje ose të vihet në funksionim një qendër telefonike pa pagesë për informacionin në fjalë. Konsiderojmë se detyrimet për informim të konsumatoreve në bazë të Ligjit 9918 dhe Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatoreve duhet të jenë të njëjta për të gjithë operatorët dhe ofruesit e shërbimit në treg pavarësisht shërbimit me karta të parapaguara. Ligji nuk të lë vend për interpretim që AKEP të ketë të drejtë të përcaktojë detyrime informimi “më të lehtësuara” për ofrues të caktuar shërbimi. Kjo do të ishte diskriminuese dhe në dëm edhe të konsumatorëve. Theksojmë se duke qenë që operatorët me karta të parapaguara konkurrojnë me anë të çmimit, informacioni mbi çmimin duhet të jepet me të gjitha mënyrat e informimit që parashikon Ligji 9918 dhe në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, dhe jo metoda të caktuara informimi të lihen si një alternativë.

Qëndrimi i AKEP për komentet e mësipërme:

AKEP bazuar në rregullimet e akteve ligjore dhe nënligjore sqaron se transferimi i numrave dhe serive numerike tek të tretët nuk nënkupton transferimin e numrave tek pajtimtarët por tek sipërmarrës të tjerë që zhvillojnë aktivitet në fushën e komunikimeve elektronike. Numrat dhe seritë numerike nuk janë pronë e sipërmarrësve, atyre u jepet e drejta për përdorim nga AKEP dhe meqenëse janë burime të kufizuara nevojitet një miremenaxhim i tyre nga ana e AKEP. Për këtë arsye mund të parashikohet e drejta e AKEP për të hequr të drejtën e përdorimit të numrave automatikisht me kalimin e një afati 3 vjeçar në rast se numrat nuk përdoren nga sipërmarrësi. I njëjti shpjegim është edhe për rastin e mospërdorimit të frekuencave nga sipërmarrësit për 1 vit nga data kur janë caktuar këto frekuenca.

AKEP, vlerëson se afatet e përcaktuara në pikën 3.1.4 të Aneksit C të rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm janë të përshtatshme për shqyrtimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe krijojnë mundësinë e komunikimit dhe ndryshimeve të mundshme në dokumentacionin e paraqitur.

AKEP, vlerëson se detyrimet e përcaktuara në pikën 3.1.8 të Aneksit C të rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm janë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe shkon përshtat me misionin e AKEP dhe të vetë sipërmarrësve që ofrojnë shërbime për konsumatorët.

AKEP vlerëson se detyrimet e përcaktuara në pikën 3.5 të Aneksit C të rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm janë në përputhje të plotë me aktin rregullator të AKEP mbi dërgimin e të dhënave statistikore dhe financiare për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime në fushën e komunikimeve elektronike dhe nuk përbën një detyrim të ri për sipërmarrësit.

AKEP vlerëson se detyrimi i parashikuar në pikën 3.6 të Aneksit C të rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm është në përputhje me rregullimet e ligjit 9918 për komunikimet elektronike.